



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Inspektoratin Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me temë “Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS “BLERJET ONLINE NË SHQIPËRI, TAKSAT DHE SHËRBIMI NDAJ QYTETARIT”

Tiranë, 2025

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJA	4
2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT	5
2.1 Konteksti i problemit social.....	5
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	6
3. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM	6
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	6
3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	8
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	10
3.4 Pesha në buxhet.....	11
3.5 Feedback-u i subjektit në fazën studimore.....	12
4. DETAJET E AUDITIMIT	12
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	12
4.2 Objektivi i auditimit.....	14
4.3 Pyetjet e auditimit.....	15
4.4 Fushëveprimi i auditimit.....	16
5. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	16
5.1 <i>A është fusha e blerjeve on-line e plotësuar me kuadrin ligjor e rregullator të nevojshëm?</i>	16
5.2 <i>A janë procedurat e ndërmarra nga ana e institucioneve të mjaftueshme për formalizimin e kësaj veprimtarie?</i>	24
5.3 <i>A ka funksionuar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve në fushën e blerjeve on-line për garantimin e qytetarit?</i>	37
6. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE	40

Lista e shkurtimeve

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1	RSH	Republika e Shqipërisë
2	BE	Bashkimi Evropian
3	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
4	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
5	MF	Ministria e Financave
6	DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
7	DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
8	DRT	Drejtori Rajonale Tatimore
9	AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
10	ISHMT	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
11	PSH	Posta Shqiptare
12	INSTAT	Instituti i Statistikave
13	MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
14	IDP	Information and Data Protection Commissioner
15	EUROSTAT	The statistical office of the European Union
16	SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
17	PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
18	OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
19	E-GOV	Electronic Government
20	AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
21	PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
22	INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
23	EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
24	ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
25	3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
26	SWOT	Fuqitë, Dobësitë, Shanset, Kërcënimet

1. PËRMBLEDHJE

Auditimi me temë: “Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit” kishte si objektiv vlerësimin e masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse lidhur me blerjet online dhe efektivitetin e tyre. Ndërsa tregtia online në Shqipëri po njej një zhvillim të qëndrueshëm, është thelbësore që kjo rritje të shoqërohet me masa të mirëstrukturuara për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me informalitetin, sigurinë e konsumatorit dhe mbrojtjen e të dhënave. Mbetet detyrë e institucioneve qendrore dhe vendore të kujdesen në mënyrë konsistente për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për zhvillimin e blerjeve online, duke vepruar në mënyrë të koordinuar për të përmbushur standardet ligjore dhe për të garantuar interesin e qytetarit. Nga ana tjetër, institucionet politikbërëse duhet të përqendrohen në hartimin e politikave të qarta dhe objektive që rregullojnë proceset e tregtisë elektronike dhe forcojnë rolin mbikëqyrës të strukturave përgjegjëse. Po ashtu, është e domosdoshme të intensifikohet koordinimi ndërinstitutional, të rritet ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe të trajnohet administrata publike në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe sfidat e tregut dixhital.

Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëpërmjet identifikimit të mangësive, shkallës së zbatimit të standardeve dhe propozimit të masave korrigjuese për të përmirësuar zbatimin e politikave dhe procedurave në lidhje me blerjet online, garantimin e sigurisë së konsumatorit, eliminimin e konkurrencës së pandershme dhe rritjen e të ardhurave buxhetore. Auditimi u krye për veprimtarinë e institucioneve gjatë periudhës periudhën 01.01.2020 -31.12.2024.

Për shkak të kompleksitetit të tij auditimi ka një qasje në nivel sistemi, duke parë nga ana e detyrimeve që subjektet nën auditim kanë për blerjet online në bazë të fushës së tyre të përgjegjësisë shtetërore, në lidhje me hartimin, zbatimin e politikave por dhe implementimin e tyre. Rëndësi iu kushtua gjithashtu bashkëpunimit mes aktorëve të cilët fusha e përgjegjësisë institucionale lidhet me tregtinë online dhe shërbimin ndaj qytetarit. Gjatë këtij auditimi u fokusuar në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me njësitë e tyre të varësisë, Inspektoratit Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Subjektet e përzgjedhur si edhe periudha e auditimit mundësoi një panoramë më të plotë lidhur me kompetencat dhe proceset që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të mirë menaxhimit. Auditimi u orientua në tre kolona bazë si, plotësia e kuadrit ligjor dhe rregullator ekzistues, procedurat e ndërmarra nga institucionet për formalizimin e kësaj veprimtarie, bashkëpunimin mes institucioneve për garantimin e të drejtës së qytetarëve.

Sa më sipër, masat e marra nga institucionet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë nuk janë të mjaftueshme për rregullimin e kësaj veprimtarie. Evidentohet, mungesa e një dokumenti politik të dedikuar në tregtinë elektronike (*e-commerce*¹). Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit e miratuar në Maj 2024, megjithëse një hap pozitiv, mbetet e fragmentuar dhe nuk përfshin të gjitha institucionet kyçe në planet e saj të veprimit.

Nga ana tjetër, veprimtaria e institucioneve ligj zbatuese shoqërohet me mekanizma të pamjaftueshëm të kontrollit dhe mbikëqyrjes, në disa raste pjesërisht funksionale, duke lënë hapësira të mundshme për informalitet dhe abuzime. Koordinim i dobët vihet re mes institucioneve të cilët megjithëse në disa raste kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi mes tyre, nuk i kanë shfrytëzuar ato për shkëmbimin e rrjedhshëm të informacionit, apo për të ndërmarrë veprime të përbashkëta në drejtim të përmirësimit të gjendjes. Vlerësimi i ngritjes së një platforme të përbashkët dixhitale për ndarjen e të dhënave në kohë reale ndërmjet

¹ Në material termat, blerje online, tregti elektronike, *e-commerce* trajtohen në të njëjtin kontekst.

institucioneve do të krijonte mundësi për gjurmueshmëri dhe ndërhyrje efektive në tregtinë online.

Në përfundim janë gjeneruar gjetje të cilat theksojnë mangësi të subjekteve nën auditim për të cilat janë dhënë rekomandime specifike shoqëruar me afatet kohore konkrete për zbatimin e tyre.

2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

2.1 Konteksti i Problemit Social

Blerjet “online” i referohen porosive të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet internetit, brenda dhe jashtë vendit, për qëllime personale jo tregtare, përmes çdo lloji pajisjeje: kompjuter, laptop i lëvizshëm ose i dorës, telefonin celular, telefon smart, etj., Me zhvillimin e teknologjisë, në dekadat e fundit blerjet online janë trend i ri i përditshmërisë për miliona njerëz në mbarë botën. Avantazhi i blerjeve online, qëndron në faktin që shërbimi që merret online është në nivel shumë më i lartë sesa shërbimi që mund të ofrohet fizikisht në dyqanet fizike dhe konsumatori ka mundësi të bëjë zgjedhje, pa pasur presion për kohën që mund të harxhojë.

Edhe pse blerjet online ofrojnë mundësi të shumta dhe e kanë bërë më të lehtë jetën për shumë njerëz në botë, ato kanë edhe disavantazhet të tyre siç mund të jenë, rreziqet e perceptuara të cilët përfshijn faktorët si: vonimi i porosive; pa mundësia për të parë fizikisht mallin para blerjes; mashtrimet dhe problemet e mallrave dhe shërbimeve; sigurimi i cilësisë së mallrave dhe shërbimeve, siguria e përdorimit të sistemit të kartave të kreditit, etj.

Blerjet online ose ndryshe tregtia elektronike, në Shqipëri ka filluar të njihet në fillim të viteve 1990, e cila po përdoret nga konsumatorët si një metodë tjetër alternative e shitjeve dhe blerjeve të mallrave dhe shërbimeve.

Sipas legjislacionit shqiptar, kufiri maksimal i taksueshëm për blerje online nga jashtë vendit para vitit 2016, ka qenë mbi 150 Euro dhe në gusht të vitit 2016, në frymën e Direktivave të BE² hyri në fuqi një VKM³ me të cilin kufiri maksimal i taksueshëm për blerjet online u ul dhe u bë mbi 22 Euro (mbi këtë vlerë taksohet TVSH me 20% dhe taksë doganore me 4%). Në muajin shkurt 2018, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me një udhëzim të posaçëm⁴, ka përcaktuar procedurën e taksimit dhe qarkullimit të lirë të mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra nëpërmjet blerjeve online. Ndërkohë edhe blerjet online brenda vendit vitet e fundit kanë patur rritje.

Banka Botërore në Raportin e vitit 2017⁵ e ka renditur Shqipërinë të fundit në rajon për blerjet online me vetëm 5%, një vend para saj qëndron Kosova me më shumë se 10%. Ndërsa deri në këtë vit, vendet me përqindje të lartë në konsumin e mallrave online në botë janë SHBA-ja dhe Gjermania, me mbi 60% të blerjeve online.

Nga të dhënat e Eurostat⁶, në vitin 2019, për Shqipërinë, vetëm 7% konsumatorëve shqiptarë përdorën internetin për të porositur mallra apo shërbime, nga 5% që ishte në vitin 2018. Ndërsa të dhënat për vitin 2021 tregojnë se rreth 21% e shqiptarëve që kanë përdorur internetin kanë bërë blerje online, nivel ky shumë më e ulët sesa mesatarja evropiane që është 74%.

Në vitet e fundit, blerjet online kanë pasur një rritje drastike në mbarë vendet e botës për shkak të pandemisë Covid-19, nëse shohim të dhënat e rajonit, më mirë renditet Serbia, me 52.9% të popullsisë, e ndjekur nga Kosova, që i ka të dhënat për vitin 2020, me 47.7%, Maqedonia e

² Direktiva e BE-së 2006/79/EC

³ VKM nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

⁴ Udhëzim nr. 2, datë, 02.02.2018 “Mbi procedurat e deklarimit dhe qarkullimit të lirë të mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerjeve online nga individ nëpërmjet operatorit postar”, i ndryshuar;

⁵ Source: World Bank Findex survey;

⁶Eurostat Website: <https://www.instat.gov.al/en/about-us/instat-and-cooperations/european-statistical-data/eurostat-website/>.

Veriut me 46.3%, Bosnjë Hercegovina, me 39%, ndërsa Mali i Zi është i parafundit përpara Shqipërisë, me 31.8%. Shqipëria paraqitet me përqindje të ulët të blerjeve online në krahasim me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian.

Në një anketim të publikuar gjatë vitit 2023 nga INSTAT, mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit nga grupmoshat 16-74 vjeç për vitin 2022 ka evidentuar se, 82,6% e kësaj fashe e përdorin internetin. Po në këtë anketë evidentohet se 34,7% e popullsisë në këtë grupmoshë ka kryer blerjet online gjatë vitit 2022. Këta tregues janë rreth 30% më të lartë se viti 2021, çka tregon që kjo lloj tregtie është duke u zgjeruar dhe duke ndikuar gjithnjë e më tepër në ekonominë e vendit.

2.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, u ndërмор auditimi me temë, “Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit”, duke e konsideruar një çështje të rëndësishme dhe me impakt social. Nëpërmjet këtij auditimi synojmë të paraqesim situatën aktuale lidhur me blerjet online në vend, si dhe të analizojmë sistemin e ngritur, veprimtaritë e ndërmarra nga institucionet e përzgjedhura për auditim, në funksion të mirë funksionimit të proceseve dhe garantimit të sigurisë për konsumatorin vendas. Në përfundim të auditimit janë dhënë rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

3. SUBJEKTET NËN AUDITIM

3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet e përfshira në këtë auditim janë:

1. Ministria e Financave;
2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësi në varësi të saj;
3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe njësi në varësi të saj;
4. Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut;
5. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ministria e Financave në cilësinë e institucionit epror politikbërës në fushën fiskale dhe monitorimit të treguesve të tregut, ka për mision arritjen e stabilitetit ekonomik nëpërmjet drejtimit me efektshmëri, efektivitet dhe transparencë të financave publike. Ministria e

Financave e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

- a) politikën makroekonomike dhe fiskale;
- b) administrimin e të ardhurave;
- c) administrimin e buxhetit të shtetit;
- ç) menaxhimin e borxhit publik dhe garancive shtetërore të huasë;
- d) administrimin financiar;
- dh) menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- e) menaxhimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian;
- ë) inspektimin financiar publik;
- f) bashkërendimin e përgjithshëm të auditimit të brendshëm;
- g) parandalimin e pastrimit të parave dhe terrorizmit;
- gj) lojërat e fatit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

DPD është institucion në varësi të Ministrisë së Financave. Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar dhe për këtë qëllim Autoritetet doganore synojnë mbrojtjen e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit; garantimin e sigurisë e të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe të banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera; mbajtjen e balancës së duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.

Doganat shqiptare për përmbushjen e misionit të tyre, përcaktojnë parimet strategjike:

- Parimi i mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë;
- Parimi i mbështetjes së konkurrueshmërisë së kompanive shqiptare;
- Parimi i lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme;
- Parimi i kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave;
- Parimi i bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit;

Në vizionin e saj Administrata Doganore Shqiptare ka veprimtarinë në harmoni të plotë me standardet dhe praktikat më të mira të BE – së. Një institucion publik modern, profesional, i paanshëm, i ndershëm, i besueshëm dhe i pa korrumpuar si një partner mbështetës i komunitetit tregtar dhe ruajtës efikas i shoqërisë dhe zinxhirit të furnizimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

DPT është institucion në varësi të Ministrisë së Financave. Misioni i Administratës Tatimore është të kontribuojë në mbulimin e shpenzimeve publike të qeverisë, përmes mbledhjes efektive dhe efikase të të ardhurave tatimore, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave.

Krahas kësaj, institucioni siguron informacion, në mbështetje të hartimit të politikave ekonomike të qeverisë.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, Administratës Tatimore asiston tatimpaguesit me shërbime të cilësisë së lartë, në mënyrë që ata t'i përmbushin vetë detyrimet e tyre fiskale sipas

legjislacionit. Në të njëjtën kohë, Administrata Tatimore vepron kundër sjelljeve të cilat nuk janë në përmbushje të kërkesave ligjore.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut

ISHMT organizohet si Drejtori e Përgjithshme me juridiksion në të gjithë territorin e vendin.

Misioni i tij është:

- garantimi i sigurisë së produkteve për konsumatorët,
- respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Ky mision realizohet nëpërmjet veprimtarisë mbikëqyrëse në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

ISHMT-ja është përgjegjëse për inspektimin e zbatimit të kërkesave të detyrueshme ligjore në fushën e:

- mbrojtjes së konsumatorëve, sipas përcaktimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- mbrojtjes së pronësisë industriale, sipas përcaktimit të legjislacionit për pronësinë industriale;
- garantimit të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, sipas përcaktimit të legjislacionit respektiv;
- inspektimit metrologjik, sipas legjislacionit për metrologjinë;
- etiketimit për konsumimin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, sipas përcaktimit të legjislacionit për informacionin e konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji;
- kontrollit të detergjentëve të vendosur në treg sipas dispozitave të ligjit për detergjentët;

Agjencia Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Qëllimi i këtij misioni është kryerja e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe vendosja e sanksioneve në rastet e vërtetimit të kundërvajtjeve administrative, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore, kompetencat e AKEP dhe parimet e së drejtës.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është përcaktuar si autoriteti kombëtar përgjegjës që nxit zhvillimin e sektorit postar duke zbatuar procedurat e autorizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. AKEP harton dhe miraton rregulloret në zbatim të ligjit 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar.

Bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e rregullimit të shërbimeve postare. Harton dhe miraton standardet dhe kushtet teknike për ofrimin e shërbimit postar në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare përfshirë standardet për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar.

Kujdeset që konkurrenca ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare të mbështetet në parimet e transparencës, mos diskriminimit dhe ndershmërisë.

Mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesit e shërbimeve postare në përmbushje të detyrave rregullatorë në zbatim të këtij ligji duke garantuar ruajtjen e sekretit për informacionin e dhënë.

Miraton kushtet dhe termat e përgjithshme të shërbimeve postare.

Miraton tarifat për ofrimin e shërbimit/ëve universal postar.

Zgjidh mosmarrëveshjet midis ofruesve të shërbimit postar.

Mbron të drejtat e përdoruesve të shërbimeve postare, dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve postare.

Bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës dhe Autoritetin për Mbrojtjen e Konsumatorit në çështjet me interes të përbashkët. Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare Rregullatore të Shërbimeve Postare.

3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

3.2.1 Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar” ;
- Ligji nr. 92/2014 “ Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar dhe Udhëzimet përkatëse sipas fushës veprimit”;
- Ligji nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- Ligj nr.102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”⁷ ;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10480, datë 17.11.2011“Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore⁸;
- Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Dispozitat e ligjit nr. 7850 “Kodi Civil” date 29.07.1994, i ndryshuar, që rregullojnë aspekte të ndryshme në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;
- Ligji nr.10 480, date 17.11.2011 “Për sigurinë e Përgjithshme të produkteve jo ushqimore⁹”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10433, datë 16.6.2011“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për Komunikimet Elektronike”;
- Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”;
- në Republikën e Shqipërisë”;
- Të tjera.

3.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit

- Strategjia ndër sektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2014–2020”;
- Strategjia ndër sektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut 2024–2030” miratuar me VKM nr. 326 datë 29.05.2024;

⁷ Përafuar pjesërisht Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE) nr.952/2013, datë 9 tetor 2013, “Mbi përcaktimin e Kodit Doganor të Bashkimit Evropian”, numri CELEX: 32013R0952, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 269, datë 10.10.2013, faqe 1-101.

⁸ I azhurnuar me Ligjin Nr. 17/2013

⁹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën nr. 2001/95/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 3 dhjetor 2001 “Mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve. Numri CELEX:32001L0095, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.177, date 15.1.2002, faqe 4-17. Rregulloren nr. 765/2008/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 i°Mbi vendosjen e kërkesave për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut lidhur me tregtimin e produkteve±, e cila shfuqizon rregulloren Nr. 339/93/KEE. Numri CELEX:32008R0765, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 218, datë 13.8.2008, faqe 30-47.

- VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr.36, datë 20.1.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”(ndryshuar me VKM nr. 338, datë 6.6.2018; nr. 172, datë 18.3.2022),(i përditësuar);
- VKM nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” të ndryshuar;
- VKM nr. 921, datë 29.12.2014¹⁰¹¹¹²¹³ “Për personelin e Administratës Doganore”;
- Udhëzimi nr.02, date 15.01.2018 "Udhëzim për deklarimin e mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje “online” nëpërmjet operatoreve postar", ndryshuar me udhëzimin nr. 02, datë 01.03.2019;
- Udhëzimi nr. 02, datë 11.03.2024 “Deklarimi i para mbërritjes/para nisjes dhe procedura të thjeshtuara për mallrat që importohen apo eksportohen nëpërmjet postës së shpejtë”;
- Urdhri nr. 16, datë 08.03.2024 “Për miratimin e planit zbatues të strategjisë së biznesit të administratës doganore Shqiptare 2024-2025”;
- Rregullore nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”;
- Rregullore nr. 2 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL”, dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”;
- Rregullore për Autorizimin Individual miratuar me VKD nr. 510 datë 04.11.2008, shfuqizuar sipas nenit 13 të rregullores nr. 30 datë 05.12.2013, miratuar me VKD nr.2395, datë 05.12.2013;
- Rregullore e Autorizimit të Përgjithshëm nr. 47, datë 26.10.2017;
- Rregullore nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
- Raporte vjetore monitorimi të institucioneve ndërkombëtare për blerjet online;
- Raport monitorimi “Strategjia ndër sektoriale për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut 2014-2020;
- Marrëveshje bashkëpunimi “Për deklarimin përmbledhës të hyrjes/daljes në doganë” ndërmjet Postës Shqiptare, protokolluar me nr.951/8 datë 07.12.2023 dhe DP Doganave protokoll nr.7927/101 datë 11.12.2023.

Kriteret e tjera/Praktikat e mira:

- Direktiva 2006/79/EC e datës 5 Tetor 2006 “Mbi përjashtimin nga taksat e importit të dërgesave të vogla të mallrave me natyrë jo tregtare nga vendet jashtë BE-së”. Celex nr. 32006L0079; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, Nr. 286, 17 October 2006, faqe 15-18;
- Direktiva 2009/132/EC e datës 19 Tetor 2009 “Mbi përcaktimin e qëllimit të nenit 143 (b) dhe (c) të Direktivës 2006/112 / EC në lidhje me përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin final të mallrave të caktuara”. Celex nr. 32009L0132; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, 292, 10 Nëntor 2009, faqe 5-30;
- Progres Raport BE 2022¹⁴;

¹⁰ Ndryshuar me VKM nr.9, datë 11.01.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”.

¹¹ Ndryshuar me VKM nr. 2, datë 8.1.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar

¹² Ndryshuar me VKM Nr. 899, datë 18.11.2020

¹³ Ndryshuar me VKM Nr. 355, datë 26.5.2022

¹⁴ EUROPEAN COMMISSION, Brussels, 12.10.2022, SWD(2022) 332 final

- Progres Raport BE 2023¹⁵;
- Të tjera.

3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike gjatë viteve të fundit kanë vijuar të jenë mbështetës të rëndësishëm të lehtësimit të komunikimit ndërmjet konsumatorëve si dhe përdorimit prej tyre të platformave elektronike online që mundësojnë ofrimin e shërbimeve të ekonomisë digjitale siç është edhe ajo e tregtisë elektronike. Një ndër ndryshimet kryesore në shërbimet postare gjatë viteve të fundit është zhvendosja nga komunikimi tradicional i bazuar në letër drejt komunikimeve me mjete elektronike, gjë e cila ka çuar në rënie të sasisë së objekteve postare. Në të njëjtën kohë, digjitalizimi ka nxitur rritjen e sasisë së pakove postare për shkak të rritjes së tregtisë elektronike.

Veprimtaria tregtare nëpërmjet platformave elektronike online, është përfshirë si çështje në Strategjinë Ndërsektoriale “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024-2030” të miratuar me VKM nr.326 datë 29.05.2024¹⁶. Kjo strategji është dokumenti politik i cili vendos në qendër konsumatorët dhe ka për qëllim fuqizimin e tyre për një rol aktiv në treg, duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mirë informuar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Strategjia ndër sektoriale “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024-2030, është hartuar dhe miratuar në vijim të masave që përmbante strategjia e mëparshme e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2014- 2020.

Risia e kësaj Strategjia është se ajo orienton fushat që do të jenë më shumë në vëmendje deri në vitin 2030, ndër to edhe fushën e tregtisë elektronike ose e thënë ndryshe fushën e blerjeve online nga konsumatorët.

Për implementimin e strategjisë, për rregullimin e fushës së tregtisë elektronike është ngritur grup pune për hartimin e planit të veprimit me përbërje përfaqësues të disa institucioneve. Grupi i punës ka draftuar planin e veprimit i cili është në pritje të miratimit nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës, dhe Inovacionit.

Në përgjithësi për çështjet e mbrojtjes së interesave ekonomike dhe të drejtave të tjera të konsumatorëve, vepron Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

Në veçanti për tregtinë elektronike (blerjet online) vepron VKM nr.919, datë 29.12.2014 “Për miratimin e dispozitave të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁷ dhe Udhëzimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 2, date, 02.02.2018 “Mbi procedurat e deklarimit dhe qarkullimit të lirë të mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerjeve online nga individ nëpërmjet operatorit postar”, i ndryshuar.

Ndërsa fusha e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare rregullohet nga Ligji nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹⁸ dhe nga Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Të gjitha këto ligje së bashku me akte të tjera nënligjore dhe plani i veprimit të masave që pritet të miratohet, krijojnë bazë rregullatore në mbrojtje të konsumatorëve përkundrejt praktikave të padrejta tregtare në fushën e tregtisë elektronike.

¹⁵ EUROPEAN COMMISSION, Brussels, 08.11.2023, SWD(2023) 690 final

¹⁶ VKM nr.326 datë 29.05.2024 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024-2030”

¹⁷ VKM nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,

¹⁸ me Ligjin nr. 102/2012 datë 24.10.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

3.4 Pesha në buxhet

Administrata tatimore së bashku me administratën doganore janë institucionet më të rëndësishme në vend për mbledhjen e të ardhurave buxhetore. Administrata doganore mbledh detyrimet doganore nga importi, ndërsa ajo tatimore mbledh detyrimet tatimore për veprimtarinë e kryer nga tatimpaguesit brenda vendit. Veprimtaria që këto institucione zhvillojnë dhe performanca e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë në të hyrat buxhetore që gjenerohen në shkallë vendi. Në bazë të të dhënave të paraqitura nga DPT dhe DPD, më poshtë paraqesim treguesit financiarë mbi vlerat e të ardhurave të mbledhura sipas periudhës.

Të ardhurat e mbledhura nga DPT¹⁹ dhe pesha që zë veprimtaria online në to paraqitet në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr. 1 Të dhëna mbi të ardhurat e mbledhura nga DPT në vitet 2020-2024 (Në mijë lekë)

Viti	Të Ardhurat të mbledhura nga DPT gjithsej	Te ardhura të mbledhura nga Veprimtaria online	Pjesa që zë Veprimtaria online në %
2020	218,987,895	244,721	0.11%
2021	242,459,033	309,359	0.13%
2022	285,560,338	344,712	0.12%
2023	334,518,271	368,580	0.11%
2024	383,274,261	323,725	0.084%

Burimi: DPT, përpunuar nga grupi i auditimit.

Të ardhurat e mbledhura nga DPD²⁰ dhe pesha që zë veprimtaria online në to paraqitet në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr. 2 Të dhëna mbi të ardhurat e mbledhura nga DPD në vitet 2020-2023 (Në mijë lekë)

Viti	Të ardhurat doganore	Te ardhura të mbledhura nga Veprimtaria online	Pjesa që zë Veprimtaria online në %
2020	153,032,595	4,022,873	2.6%
2021	192,840,526	5,218,633	2.7%
2022	223,089,586	4,527,027	2.0%
2023	216,804,647	4,869,706	2.2%

Burimi: DPD, përpunuar nga grupi i auditimit.

3.5 Feedback-u i subjekteve nën auditim

Gjatë auditimit institucionet, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë kërkesave për informacion/dokumentacion, pyetësorëve të dërguar, takimeve konsultuese. Vlen të theksojmë disponibilitetin e paraqitur nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare gjatë fazës së auditimit në terren. Këto subjekte vlerësuan takimet me grupin e auditimit edhe duke patur përfaqësim me personat përgjegjës të departamenteve dhe drejtorive të ndryshme, të lidhura me çështjet e auditimit.

¹⁹ Në të ardhurat e mbledhura nga DPT përfshihen edhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

²⁰ Në të ardhurat e mbledhura nga DPD përfshihen detyrimet doganore të paguara për pakot të dërguara nëpërmjet shërbimit postar në import nga qytetarët si edhe nga subjektet tregtare.

4. DETAJET E AUDITIMIT

4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit


Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në veprimtarinë e subjekteve nën auditim, që lidhen me blerjet online. Analiza SWOT është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizajnuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. Për kryerjen e analizës grupi i auditimit ka përcaktuar objektivin që synohet të arrihet përmes këtij auditimi, ka mbledhur të dhëna dhe evidenca dhe ka bashkërenduar mendimet dhe konceptet e secilit prej anëtarëve të grupit.

U përzgjedh përdorimi i analizës SWOT nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e një menaxhimi më efikas të mangësive në proceset e ndërmarra.

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Fig.1 Analiza SWOT



Burimi: Grupi i auditimit

Tabela. 3: Analiza e Riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Mungesë e një strategjie ndër sektoriale të dedikuar për blerjet online dhe planet e veprimit.	Risk Strategjik	I lartë
2	Përfshirja e pakët e fushës së shitjeve online në strategjitë sektoriale dhe ndër sektoriale të hartuara.		I mesëm
3	Aktivitete të pakta ndërgjegjësuere apo informuese, mbi të drejtat e konsumatorit.		I mesëm
4	Mungesa e planeve nga institucionet qendrore për monitorimin e veprimtarive lidhur me blerjet online si dhe formalizimi i gjurmës së auditimit për to.		I lartë
5	Mungesë e të dhënave të detajuara mbi blerjet online në planifikimin e të ardhurave buxhetore.	Risk Financiar	I mesëm
6	Iniciativa ligjore të papërfunduara me impakt dhe akte rregullative të pa përditësuara.	Risk Rregullator dhe Juridik	I mesëm
7	Kufizime në përdorimin e kompetencave institucionale.	Risk Operacional	I lartë
8	Mungesë monitorimi mbi operatorët ekonomikë.		I lartë
9	Njohje e pakët e këtij aktiviteti nga stafet e ngarkuara dhe trajnimi i pamjaftueshëm i tyre:		I mesëm
10	Struktura përgjegjëse të cilat përmbushin edhe detyra të tjera.		I mesëm
11	Koordinim dhe bashkëveprim i pamjaftueshëm mes aktorëve në proces.		I lartë
12	Paqartësi në rolet institucionale mbi trajtimin e rasteve.		I mesëm
13	Monitorim jo i plotë i proceseve nga ana e institucioneve kryesore përgjegjës.		I mesëm


Burimi: Grupi i Auditimit

4.2 Objektivat e auditimit

Auditimi me temë “Blerjet online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit”, kishte si objektiv kryesor vlerësimin e masave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe efektivitetin e tyre në menaxhimin e tregtisë elektronike, me fokus të veçantë në formalizimin e veprimtarisë, mbrojtjen e konsumatorit dhe përmbushjen e detyrimeve fiskale. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëpërmjet identifikimit të mangësive strukturore dhe funksionale në kuadrin ligjor dhe rregullator, shkallën e zbatimit të standardeve dhe propozimin e masave korrigjuese për përmirësimin e politikave dhe procedurave në lidhje me blerjet online, garantimin e sigurisë së konsumatorit, eliminimin e konkurrencës së pandershme dhe rritjen e të ardhurave buxhetore.

4.3 Pyetjet e auditimit

Piramida e pyetjeve audituese



4.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim kishte si fushëveprim analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi mirë administrimin e proceseve me synim marrjen e masave të përshtatshme. Auditimi paraqet një qasje në nivel sistemi duke e parë nga perspektiva e detyrimeve, që subjektet nën auditim kanë për blerjet online në bazë të fushës së tyre të përgjegjësishë shtetërore. Periudha e auditimit do të jetë 01.01.2020 deri më datë 31.12.2024. Gjatë këtij auditimi u fokusua në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me njësitë e tyre të varësisë, Inspektoratit Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Subjektet e përzgjedhur si edhe periudha e auditimit mundëson pasjen e një panorame të plotë lidhur me kompetencat dhe proceset që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të mirë menaxhimit.

5. SHTJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

Pyetja Kryesore: A janë blerjet online të rregulluara dhe me standarde, në mbrojtje të interesit të qytetarit?

Mesazhi i auditimit

Tregtia online në Shqipëri vijon të rritet, por mbetet ndjeshëm prapa vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian në nivel përfshirjeje dhe formalizimi. Sipas raportit Balkan Barometer 2024²¹, vetëm një përqindje e vogël e bizneseve shqiptare realizojnë më shumë se 5% të shitjeve online, duke e renditur vendin me nivelin më të ulët të shitjeve online në rajon. Auditimi evidentoi mungesën e politikave të qarta dhe të integruara për tregtinë online nga institucionet politikëbërëse, si në aspektin e rregullimit të veprimtarive dixhitale, ashtu edhe në rolin mbikëqyrës të tyre. Nga ana tjetër, institucionet ligjzbatuese, si ato qendrore ashtu edhe ato vendore, nuk kanë arritur të përmirësojnë procedurat e brendshme për të menaxhuar risqet e blerjeve online në mënyrë efektive. Kontrollat fiskale dhe doganore janë të fragmentuara dhe mungojnë tërësisht fushatat sensibilizuese për konsumatorët dhe shitësit online. Mungesa e një qasjeje të integruar dhe mungesa e koordinimit ndërinstytucional ka lënë hapësirë për informalitet, duke kufizuar zhvillimin e tregut dixhital.

Nga institucionet përgjegjëse kërkohet një angazhim konkret për të garantuar interesin publik dhe të drejtat themelore të qytetarëve në epokën digjitale.

Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar ndërinstytucionale, përmirësimit të kuadrit ligjor, forcimit të transparencës dhe ndërtimit të besimit publik, mund të sigurohet që tregtia online të funksionojë si një mjedis i drejtë, i mbrojtur dhe i barabartë për të gjithë përdoruesit.

Ndërhyrjet nuk duhet të jenë opsionale, por prioritare për të mbrojtur besimin dhe sigurinë e qytetarëve në një ekonomi që po digjitalizohet me ritme të shpejta.

5.1 Pyetje e auditimit: A është fusha e blerjeve online e plotësuar me kuadrin ligjor e rregullator të nevojshëm?

Strategjitë institucionale nuk kanë mbuluar gjithë periudhën e auditimit.

Në kontekstin e transformimit digjital të ekonomisë shqiptare, tregtia elektronike ka marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm si kanal furnizimi për mallra dhe shërbime, si për qytetarët ashtu edhe për bizneset. Ky zhvillim është nxitur nga përparimet teknologjike dhe shfaqja e platformave digjitale që operojnë brenda dhe jashtë vendit, duke sjellë përfitime të prekshme në aspektin e aksesit, shpejtësisë dhe diversitetit të ofertës.

²¹ https://www.rcc.int/balkanbarometer/key_findings_2024/2/

Tregu online njohu një rritje të ndjeshme që prej vitit 2018, kur vetëm 5% e popullsisë kishte realizuar blerje në internet, për të arritur në 14% në vitin 2020 dhe 17% në vitin 2021.²² Gjatë periudhës së pandemisë, 54% e shqiptarëve deklaruan se kishin rritur blerjet online, ndërsa 74% e tyre shprehën gatishmërinë për të vazhduar këtë praktikë edhe pas përfundimit të krizës shëndetësore.²³

Kjo rritje ka sjellë ndikim pozitiv në uljen e papunësisë, përmes krijimit të mundësive të reja të punësimit në distancë dhe zhvillimit të modeleve të reja të biznesit. Përdoruesit më aktivë të tregtisë online janë grupmoshat 16–50 vjeç, të cilët përfitojnë nga fleksibiliteti, kursimi i kohës dhe larmia e produkteve të ofruara.

Megjithë dinamikën e zhvillimit të tregëtisë online në vendin tonë, Shqipëria ka përqindjen më të lartë të bizneseve që realizojnë shumë pak shitje online, duke reflektuar një nivel të ulët digjitalizimi në sektorin tregtar. Në kontrast, BE-ja ka një përfshirje të gjerë të konsumatorëve në blerjet online, me 65% të të rriturve që kanë blerë online gjatë vitit të fundit.

Përqindja e bizneseve që realizojnë më pak se 5% të shitjeve online (2024)

Vendi	Përqindja
AL Shqipëri	<input checked="" type="checkbox"/> 81%
XK Kosova	<input type="checkbox"/> 49%
BA Bosnje-Hercegovinë	<input type="checkbox"/> 35%
MK Maqedonia e Veriut	<input type="checkbox"/> 27%
ME Mali i Zi	<input type="checkbox"/> 12%
RS Serbia	<input type="checkbox"/> 60%
EU Bashkimi Evropian*	<input checked="" type="checkbox"/> 65% e të rriturve kanë blerë online

Burimi: Balcan Barometer 2024, Eurostat 2023

Ky kontrast tregon qartë se Shqipëria jo vetëm që ka përqindjen më të lartë të bizneseve me shitje minimale online, por edhe një hendek të theksuar me standardet e BE-së në adoptimin e e-commerce, një tregues domethënës që duhet të reflektohet drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e strategjive për zhvillimin e tregtisë elektronike. Në këtë kontekst, strategjitë kombëtare duhet të përqendrohen jo vetëm në rritjen e kapaciteteve digjitale dhe përfshirjes së bizneseve në kanalet online, por edhe në ngritjen e mekanizmave rregullatorë, përmirësimin e besimit të konsumatorëve dhe forcimin e infrastrukturës për pagesa dhe logjistikë. Vetëm përmes një qasjeje të orientuar drejt reduktimit të këtij hendeku mund të arrihet një përputhje reale me standardet evropiane dhe një aktivizim i qëndrueshëm i këtij sektori.

Gjatë periudhës së zhvillimit të tregtisë elektronike dhe rritjes së vazhdueshme të këtij aktiviteti, institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e tregut kanë ndërmarrë hapa për hartimin dhe miratimin e strategjive përkatëse. Strategjia për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2014–2020, e shoqëruar me një plan veprimi, përfshinte një kapitull të dedikuar për blerjet online dhe tregtinë ndërkufitare (përmes postës), duke adresuar nevojën për përafrim me zhvillimet teknologjike dhe praktikatat e Bashkimit Evropian.

²² <https://pcworld.al/blerjet-online-shqiperia-ne-fund-te-europes>

²³ <https://alpenews.al/pandemia-hap-portat-e-panjohura-te-ekonomise-dixhitale-54-e-shqiptareve->

Në hartimin e strategjisë 2014–2020, për shkak të mungesës së kuadrit ligjor dhe rregullator në atë kohë, u parashikua një volum i konsiderueshëm iniciativash legjislative - rreth 260 akte ligjore dhe nënligjore, nga të cilat 10–15 lidhen drejtpërdrejt me blerjet online. Ky intensitet i lartë ndryshimesh është i justifikuar në kontekstin e domosdoshmërisë për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me *acquis-in* e BE-së, me qëllim përmirësimin e sigurisë së konsumatorëve dhe ndërtimin e një infrastrukture efektive të cilësisë, në përputhje me praktikatat më të mira evropiane.

Në vijim është hartuar dhe miratuar me Vendim nr. 326, datë 29.05.2024 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030, Strategjia për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030, e cila është shoqëruar me një plan veprimi me indikatorë të matshëm.

Strategjia për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030 ka përcaktuar qartë objektivat që lidhen me tregtinë elektronike, duke theksuar mbrojtjen dhe promovimin e interesave ekonomike të konsumatorëve. Në mënyrë të veçantë, strategjia synon përmirësimin e informacionit dhe transparencës mbi tregjet dhe të drejtat e konsumatorëve, forcimin e mekanizmave efikas të dëmshpërblimit, si dhe mbrojtjen e të drejtave gjatë blerjeve online në kontekstin e transformimit dixhital.

Në seksionin që i dedikohet tregtisë elektronike, strategjia adreson çështje kyçe si: praktikatat e padrejta tregtare, zbatimi i të drejtave të konsumatorëve, kushtet e padrejta në kontrata, zgjidhja alternative dhe online e mosmarrëveshjeve, ndikimi mjedisor, turizmi dhe dixhitalizimi. Kjo qasje e bën dokumentin më të afërt me shqetësimet reale të konsumatorëve në tregun online dhe më të përafëruar me zhvillimet bashkëkohore.

Në përcaktimin e objektivave analitikë, është vlerësuar se prioritet mbetet përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve dhe të drejtave të tjera, si dhe fuqizimi i sistemit institucional për zbatimin efektiv të këtij legjislacioni. Në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, Qeveria ka vendosur si prioritet harmonizimin dhe përditësimin e legjislacionit sektorial për blerjet dhe shërbimet tregtare online.

Përcaktimi i qartë i të drejtave të konsumatorëve dhe mbështetja e tyre me akte ligjore dhe nënligjore, në përputhje me *acquis-in* e BE-së, krijon një mjedis më të sigurt dhe të besueshëm për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë, duke kontribuar në rritjen e tregtisë elektronike dhe të të ardhurave përkatëse.

Më poshtë disa nga elementët kryesorë të Strategjisë për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030, me fokus tek blerjet online dhe mbrojtja e konsumatorit:

Tabela nr. 4 Disa nga elementët kryesorë të SMKMT 2024-2030

Emërtimi	Përshkrimi
Objektivi Strategjik	Mbrojtja dhe promovimi i interesave ekonomike të konsumatorëve, përfshirë blerjet online në epokën digjitale.
Prioritetet për tregtinë online	- Zbatimi i të drejtave të konsumatorëve - Praktikatat tregtare të ndershme - Zgjidhja online e mosmarrëveshjeve - Transparenca dhe informacioni korrekt
Objektiva analitikë	- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator - Harmonizimi me direktivat e BE-së - Fuqizimi i institucioneve mbikëqyrëse

Emërtimi	Përshkrimi
Masa të propozuara	- Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore plotësuese - Trajnime për stafet institucionale - Edukimi i konsumatorit
Plan veprimi	Përfshin objektiva specifike, masa të detajuara, indikatorë monitorimi, afate kohore dhe institucione përgjegjëse
Institucione përgjegjëse	MFE, ISHMT, AKEP, AKU, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit

Burimi: SMTMK 2024-2030, përpunoi grupi i auditimi

Nga auditimi rezultoi se për periudhën 2021–2023 ka ekzistuar një vakum strategjik formal, pasi Strategjia 2014–2020 përfundoi pa u pasuar menjëherë nga një dokument i ri i miratuar. Strategjia e hartuar për periudhën 2023–2030 (me zbatim nga 2024) u hartua për të plotësuar këtë boshllëk, siç theksohet edhe në dokumentin zyrtar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky boshllëk ka ndikuar në mungesën e një plani të koordinuar institucional për mbrojtjen e konsumatorit, vonesat në përafrimin e legjislacionit me direktivat e BE-së dhe mungesën e një kuadri të qartë për mbikëqyrjen e tregut, veçanërisht në fushën e tregtisë elektronike.

Gjithashtu nga auditimi rezulton se ish-Ministria e Financës dhe Ekonomisë si institucioni politikbërës, që kishte nën përgjegjësi fushën e tregtisë (sot MEKI), mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit të Investimeve dhe Planin e saj të Veprimit²⁴, me urdhër të Ministrit nr. 190, datë 18.07.2022 ngriti një grup pune për “Hartimin e planit të veprimit për lehtësimin dhe zhvillimin e tregtisë elektronike në Republikën e Shqipërisë 2022-2023” për ti dhënë shtysë zhvillimit dhe implementimit të mëtejshëm të tregtisë elektronike. Ky grup pune do të kryesohej nga Zëvendësministri që mbulonte çështjet e ekonomisë dhe në përbërje do të kishte përfaqësues të institucioneve të tjera që lidhen me fushën e tregtisë elektronike, respektivisht: 3 pjesëmarrës nga MFE; 3 nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA); 1 nga AKEP; 1 nga DPT; 1 nga DPD; 1 nga Banka e Shqipërisë; 1 nga Shoqata Shqiptare e Bankave; 1 nga E-Albania, E-Commerce Association (AECA); 1 nga Posta Shqiptare.

Deri në periudhën e ushtrimit të këtij auditimi, nuk rezultoi të jetë hartuar dhe miratuar plani i veprimit për lehtësimin dhe zhvillimin e tregtisë elektronike.

Në DPD për zbatimin e strategjisë së biznesit të administratës doganore në Shqipëri për periudhën 2024-2025 është hartuar dhe miratuar Urdhri nr. 16, datë 08.03.2024 “Për miratimin e planit zbatues të strategjisë së biznesit të administratës doganore Shqiptare 2024-2025” si dhe janë marrë masa për vënien në zbatim e rritur efikasitetin e shërbimit të administratës doganore ndaj subjekteve juridike, fizike dhe individë për tregtinë ndërkufitare nëpërmjet platformave elektronike.

Kuadri ligjor për të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve dhe tregtarëve në tregtinë elektronike nuk është i plotë dhe i harmonizuar me direktivat e BE-së.

Administrata doganore në vijim të vlerësimit të rritjes së tregut online dhe ndërkufitar dhe nevojës për një legjislacion mbështetës e sa më të përafuar me rregullat ndërkombëtare dhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit doganor shqiptar me atë të BE-së, ka hartuar dhe dërguar për miratim ndryshimet për VKM nr. 651, datë 10.11.2017 duke synuar standardizimin e procedurave me ato të BE që lidhen me dërgesat postare. Po kështu kemi dhe Udhëzimin nr.02,

²⁴VKM nr.466, datë 30.07.2021 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Investimeve dhe planit të saj të veprimit”

datë 15.01.2018 "Udhëzim për deklarimin e mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje online nëpërmjet operatoreve postar, ndryshuar me udhëzimin nr. 02, datë 01.03.2019.

Udhëzimi nr.02, datë 11.03.2024 "Deklarimi i para mbërritjes/para nisjes dhe procedura të thjeshtuara për mallrat që importohen apo eksportohen nëpërmjet postës së shpejtë" .

DPD si pjesë e tregtisë globale është e mbështetur në legjislacionin dhe të gjitha aktet nënligjore e rregullatore në zbatim të përafritit të plotë të :

- Direktivës 2006/79/EC të datës 5 Tetor 2006 "Mbi përjashtimin nga taksat e importit të dërgesave të vogla të mallrave me natyrë jo tregtare nga vendet jashtë BE-së"²⁵.

- Direktivës 2009/132/EC të datës 19 Tetor 2009 "Mbi përcaktimin e qëllimit të nenit 143 (b) dhe (c) Direktivës 2006/112/EC në lidhje me përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin final të mallrave të caktuara".²⁶, si dhe referim të Progres Raportit të BE-së 2022-2023²⁷.

Për tregtinë elektronike (blerjet online) ka qenë në zbatim VKM nr.919, datë 29.12.2014 "Për miratimin e dispozitave të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar²⁸ dhe Udhëzimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr. 2, datë 02.02.2018 "Mbi procedurat e deklarimit dhe qarkullimit të lirë të mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerjeve online nga individ nëpërmjet operatorit postar", i ndryshuar. Caktimi i proceduarve doganore për blerjet dhe shërbimet online, janë bërë në harmonizim me rregullat që ka për fushat e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar²⁹ dhe nga Ligji nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Nga DPD po punohet në hartimin dhe miratimin e planit të veprimit të masave që është në pritje për tu miratuar dhe do të krijojë bazë rregullatore në mbrojtje të konsumatorëve përkundrejt praktikave të padrejta tregtare në fushën e tregtisë elektronike.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për blerjet online ka si bazë Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe legjislacionin shtesë që plotëson sistemin e taksimit të aktiviteteve e shërbimeve tregtare si: Ligji nr. 92/2014 " Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar dhe Udhëzimet përkatëse sipas fushëveprimit, Ligji nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" dhe akte të tjera nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet fiskale më tregun e blerjeve online.

Në pjesën e taksimit fiskal transaksionet online rregullohen sipas dispozitave të përgjithshme ligjore. Megjithatë paraqitet nevojë për unifikim të veprimtarisë dhe kontributit në rregullimin e formalizimit e këtij tregu në bashkëpunim dhe me institucionet e tjera monitoruese e mbikëqyrëse si AKEP, ISHMT, etj.

ISHMP dhe AKEP funksionojnë sipas ligjeve organike, përkatësisht:

- ISHMT ka si bazë ligjore të funksionimit Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe krijuar me VKM Nr. 36, datë 20.1.2016 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut", ndryshuar me VKM nr. 338, datë 6.6.2018; nr. 172, datë 18.3.2022, i përditësuar. Referim kryesor përveç tagrave të tjera dytësore, bazë ka Ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, Ligjin nr. 10480, datë 17.11.2011 "Për sigurinë e përgjithshme të

²⁵ Celex nr. 32006L0079; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, Nr. 286, 17 October 2006, faqe 15-18;

²⁶ Celex nr. 32009L0132; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian Seria L, 292, 10 Nëntor 2009, faqe 5-30

²⁷ - Progres Raport BE 2022²⁷; Progres Raport BE 2023²⁷;

²⁸ VKM nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë",

²⁹ me Ligjin nr. 102/2012 datë 24.10.2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"

produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar dhe Ligji nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore³⁰, etj.

Megjithëse ka një legjislacion të plotë për aktivitetin e saj tërësor, mungojnë aktet ligjore apo nënligjore për mbikëqyrjen e tregut të blerjeve online. ISHMT nuk është pjesë apo kontribuese në hartimin e akteve rregullatorë. Aktiviteti i këtij institucioni paraqet mangësi në kompetencat ligjore për tregun online, ndërkohë që roli i tij në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në tregun online dhe formalizimin e këtij tregu është mjaft i rëndësishëm.

- AKEP mbështet në bazën ligjore në fuqi, Ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ndryshuar me Ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012, nr. 107/2018, datë 20.12.2018; nr. 92/2019, datë 18.12.2019) (i përditësuar), Ligji nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”³¹ dhe Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” dhe akte të tjera rregullatore.

Qëllimi i Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka qenë në fuqi është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike, si dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në vështrimin e nevojës ligjore për mbulimin e aktivitetit të AKEP, konstatohet se për blerjet online ky institucion ka një funksion të rëndësishëm për monitorimin e regjistrimit të domaineve të individëve apo subjekteve tregtarë të cilët përdorin platforma të ndryshme digjitale dhe elektronike, por legjislacioni ekzistues i kufizon disa veprime në këtë fushë dhe veçanërisht në bashkëpunimin që duhet të ketë ky institucion me institucionet e tjera monitoruese e mbikëqyrëse të tregut online.

Pengesë është dhe iniciativa e përmirësimit apo plotësimit ligjor, pasi AKEP i përcjell propozimet nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), pra ka dhe pengesa institucionale nga propozimi deri në dërgimin në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë të një amendamenti ligjor e nënligjor.

Vitet e fundit shërbimi postar është zhvilluar shumë në drejtim të blerjeve online³², *e-commerce* duke sjellë paralelisht ulje të shërbimeve standarde të postës, siç janë dërgesat e letrave, telegrameve etj., e duke bërë që si tregtarët dhe blerësit, ashtu edhe ofruesit e shërbimeve postare të përshtaten me modele të reja të biznesit dhe të lindi nevoja për një qasje të rregullatore. Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” i cili ushtron efektet e tij prej 10 vitesh dhe evidenton nevojën për ndryshime lidhur me mënyrën e funksionimit të hallkave *e-commerce*, e në këtë kuadër, nevojë për rishikim paraqet edhe kuadri rregullator, kjo edhe në zbatim të rekomandimeve të Grupit të Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Postare (The European Regulators Group for Postal Services- ERGP). Duke qenë se vitet e fundit ka një rritje të blerjeve online, nga faqet zyrtare web, apo edhe nga faqet reklamuese në rrjetet sociale të tregtarëve të ndryshëm, dhe ngërçet apo vakumet e ligjeve aktuale është evidentuar fenomeni që punonjësit përgjegjës për dorëzimin e objekteve postare të funksionojnë jo vetëm si korrierë, por edhe si agjentë monetarë. Fenomeni i punonjësve të dorëzimit që veprojnë si agjentë monetarë është një realitet i raportuar në terren, veçanërisht në mungesë të rregullave të qarta për pagesat në dorë dhe kthimet e produkteve. Ky është një tregues i qartë i vakumit rregullator, që kërkon ndërhyrje për të garantuar sigurinë ligjore dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

³⁰ I azhurnuar me Ligjin Nr. 17/2013

³¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me: Direktivën (BE) 2018/1972, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”. Numri CELEX 32018L1972, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 321, datë 17.12.2018, f. 36–214.

³² Raporti i AKEP për vitin 2023

Këto problematika, por jo vetëm, që kanë dalë në blerjet online evidentojnë nevojën për një përafrim të ngushtë të kuadrit ligjor e rregullator me direktivat e BE-së.

Gjatë viteve 2021-2022 tregu postar dhe sidomos ai i shërbimeve online ka ardhur në rritje të ndjeshme dhe kjo ndikuar edhe nga situata pandemike Covid -19, duke rritur numrin e ofruesve të licencuar të shërbimit postar për blerjet online, ku në vitin 2022 numri i subjekteve të regjistruar në Regjistrin e Përgjithshëm të AKEP ka arritur në 36 subjekte.

Ky treg, siç është theksuar më lart, ka marrë një vëmendje të shtuar në lidhje me mënyrën dhe shpeshësinë e përdorimit. Qëndrueshmëria e tij mund të sigurohet përmes monitorimit të vazhdueshëm të subjekteve ekzistuese, krijimit të një tregu të hapur që lehtëson hyrjen e operatorëve të rinj duke minimizuar barrierat, si dhe përmes një angazhimi të qartë në luftën kundër informalitetit.

Kjo do të nxisë një konkurrencë të lirë dhe efektive në ofrimin e shërbimeve për blerjet online, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, rritjen e kënaqësisë së tyre dhe shtimin e shpenzimeve në këtë formë tregtie.

Trendet tregojnë një rritje në strukturën konkurruese edhe midis vetë subjekteve që kryejnë shërbime e blerje online, duke bërë që ata të fokusohen në rritjen e cilësisë së ofrimit të mallrave, rritjen e sigurisë së mallit, shtimin e investimeve në teknologji, pra krijimin e platformave sa më të besueshme dhe të shpejta në aksesim, duke krijuar aplikacione të ndryshme apo përditësuar sistemet që përdorin në funksion të kryerjes së shërbimit dhe në krijimin e mundësive të reja të ofrimit të këtyre shërbimeve. Gjithashtu, një element plotësues është edhe ndërveprimi me Institucionet Evropiane dhe globale mbi praktikën, udhëzimet dhe ndryshimet e rregullatorëve koherente me përshtatjen e zhvillimit të teknologjisë elektronike. AKEP duhet të fokusohet në garantimin e cilësisë së shërbimeve elektronike dhe në zbatimin e detyrimeve ligjore që lidhen me regjistrimin apo përditësimin e të dhënave në platformat dixhitale dhe marrjen e domain-eve. Kjo qasje do të mundësojë një konkurrencë të ndershme, mbrojtje më të fortë të përdoruesve në blerjet online dhe krijimin e një gjurme të plotë auditimi për transparencë dhe kontroll.

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës nën auditim kanë shtrirë efektet dy strategji ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut përkatësisht “Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2014-2020” dhe ajo 2024-2030. Për periudhën 2021-2023, nuk ka patur strategji ndërsektoriale apo sektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut. Kjo ka sjellë mungesë orientimi nga ana e institucioneve, ndërkohë që për këtë periudhë ecuria e blerjeve dhe shërbimeve online ka patur rritje të ndjeshme.

Ish-Ministria e Financës dhe Ekonomisë, në kuadër të *Strategjisë së Zhvillimit të Investimeve dhe Planit të saj të Veprimit*, ka ngritur një grup pune nëpërmjet Urdhrit të Ministrisë nr. 190, datë 18.07.2022, për hartimin e *Planit të Veprimit për lehtësimin dhe zhvillimin e tregtisë elektronike në Republikën e Shqipërisë për periudhën 2022-2023*. Sipas këtij urdhri, grupi i punës duhej të përfundonte hartimin e planit të veprimit deri më 31 dhjetor 2022. Nga auditimi rezultoi se ky plan nuk është miratuar dhe nuk ka ndonjë nismë të re për hartimin e një dokumenti të posaçëm politikash apo strategjie për tregtinë elektronike, duke krijuar një boshllëk në rregullimin dhe mbështetjen e këtij sektori në nivel shtetëror.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut (SMKMT) është hartuar gjatë vitit 2023, me titullin “SKMT 2023–2030”, dhe është miratuar me Vendimin nr. 326, datë 29.05.2024. Strategjia synonte që, në kuadër të përmirësimit të legjislationit, të synohet që të gjithë konsumatorët të kenë akses në mekanizmat efikase të dëmshpërblimit të ngritura nga

institucionet përkatëse si Ministria e Financës, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Nga auditimi rezultoi se nuk është ndërmarrë asnjë veprim bashkërendues për plotësimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e mekanizmave rregullatorë të nevojshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Mungesa e një platforme të dedikuar online për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) dhe Zgjidhjen Online të Mosmarrëveshjeve (ZOM) ka krijuar pengesa në funksionimin e tregut online, duke e bërë më të vështirë për konsumatorët realizimin e të drejtave të tyre.

3. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka ndërmarrë disa masa në funksion të përafrimit të procedurave doganore për tregtinë elektronike dhe ndërkufitare me acquis-in e Bashkimit Evropian si më poshtë vijon:

- Hartimin e ndryshimeve në VKM nr. 651, datë 10.11.2017, me synim standardizimin e procedurave për trajtimin doganor të dërgesave postare;
- Miratimin e Udhëzimit nr. 02, datë 11.03.2024, i cili parashikon thjeshtimin e procedurave të deklarimit për mallrat e importuara dhe eksportuara nëpërmjet postës së shpejtë, në përputhje me praktikat doganore të BE-së.

Megjithatë, nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka përfunduar hartimin dhe miratimin e Planit të Veprimit Sektorial për “*Masat e Zhvillimit të Tregtisë Elektronike dhe Blerjeve Online*”, i cili ishte iniciuar në vitin 2022, nga ministria përgjegjëse për ekonominë. Mungesa e këtij dokumenti strategjik cenon mbikëqyrjen sistematike të mallrave përmes tregtisë online dhe zgjatjen e afateve për standardizimin e rregullave, që lidhen me pagesat apo fiskalizimin e dërgesave.

4. Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregullat për ofrimin dhe sigurimin e shërbimeve postare, duke përfshirë edhe shërbimin universal postar. Megjithatë, ai paraqet mangësi në lidhje me tregtinë elektronike dhe përafrimin e plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ligji fokusohet kryesisht në rregullimin e shërbimeve postare tradicionale dhe nuk adreson në mënyrë të detajuar sfidat e logjistikës dhe shpërndarjes që lidhen me tregtinë online. Po ashtu, mungon një mekanizëm i qartë për transparencën e tarifave për dërgesat e tregtisë elektronike, duke krijuar pasiguri për bizneset dhe konsumatorët. Edhe pse Ligji nr. 46/2015 është pjesërisht i përafuar me Direktivën 97/67/KE të Parlamentit Evropian, ai nuk përfshin të gjitha elementet e nevojshme për modernizimin e shërbimeve postare në funksion të tregtisë online, siç janë standardet e sigurisë dhe mbrojtja e konsumatorit në dërgesat ndërkombëtare.

Konkluzion 1: Mungesa e strategjisë ndërsektoriale për periudhën 2021-2023, si dhe e planeve të veprimit për çdo institucion në kuadër të strategjisë ndërsektoriale 2024–2030 ka ndikuar në mungesën e koordinimit dhe fokusit institucional. Si rrjedhoja, institucionet që mbulojnë fusha të lidhura me tregtinë elektronike nuk kanë ndërmarrë masa të mjaftueshme për të mbështetur dhe mbrojtur konsumatorin vendas në këtë sektor.

Konkluzion 2: Mungesa e një platforme dixhitale për Zgjidhjen Alternative dhe Online të Mosmarrëveshjeve (ZAM/ZOM) përbën një mangësi kritike në mbrojtjen e konsumatorëve në tregtinë online. Pa një mekanizëm funksional dhe të aksesueshëm, konsumatorët përballen me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë transparente dhe efektive. Pa një platformë të dedikuar ZAM/ZOM, procesi i dëmshpërblimit mbetet i paqartë dhe i ngadalshëm, duke krijuar një hendek mes konsumatorëve dhe shitësve, si dhe duke dobësuar përpjekjet për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së.

Konkluzion 3: Mungesa e miratimit të Planit të Veprimit sektorial nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave cenon koordinimin institucional dhe mbikëqyrjen efektive të tregtisë ndërkufitare. Përfundimi dhe zbatimi i këtij plani është thelbësor për të siguruar qartësi rregullatore, formalizimin e tregut online dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke i dhënë tregtisë elektronike një strukturë më të qëndrueshme dhe të harmonizuar me praktikat evropiane.

Konkluzion 4: Shërbimi postar ka një rol kyç në mbështetjen e tregtisë online, duke mundësuar qarkullimin e mallrave brenda dhe jashtë vendit. Dinamika e rritjes së këtij tregu ka krijuar nevojën për përshtatje të kuadrit ligjor dhe rregullator, veçanërisht në harmonizimin me standardet e BE-së. Prandaj përditësimi i kuadrit ligjor “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, është thelbësor për rritjen e efikasitetit të tregtisë elektronike dhe përputhjen me standardet evropiane.

1.1. Rekomandimi: Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për ekonominë, të marrin masat për të analizuar dhe vlerësuar fushën e tregtisë elektronike, me synim hartimin e një strategjie të veçantë për zhvillimin e tregtisë online. Në këtë dokument politikash, të përcaktohen qartë objektivat dhe përgjegjësitë institucionale sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore në komunikimet elektronike, mbrojtjen e konsumatorit dhe mirë administrimin fiskal, duke përfshirë një analizë të detajuar të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve.

Brenda muajit mars 2026

2.1. Rekomandimi: Ministria e Financave, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për ekonominë, të marrin masat për hartimin e një kuadri ligjor të plotë dhe të harmonizuar me direktivat e BE-së, duke përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve dhe tregtarëve në tregtinë elektronike, duke synuar Krijimin e një platforme dixhitale për Zgjidhjen Alternative dhe Online të Mosmarrëveshjeve (ZAM/ZOM), që mundëson procedura transparente dhe të shpejta për konsumatorët.

Brenda muajit mars 2026

2.2. Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në bashkëpunim me Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrinë përgjegjëse për ekonominë të marrin masa për ndërgjegjësimin dhe informimin e konsumatorëve për të drejtat dhe mënyrat e aksesit në mekanizmat e dëmshpërblimit, përmes fushatave publike dhe nismave edukative.

Brenda muajit mars 2026

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për të përshpejtuar hartimin dhe miratimin e “Planit të veprimit sektorial të masave për blerjet online dhe tregtinë ndërkufitare”, duke siguruar qartësi në detyrat dhe afatet e institucioneve.

Brenda muajit mars 2026

4.1. Rekomandimi: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrin masa për rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator në fushën e shërbimit postar, ku të përfshihen parashikimet mbi përcaktimin e standardeve për cilësinë e shërbimeve elektronike, përmirësimin e mekanizmave të regjistrimit dhe rifreskimit të licencave për platformat dixhitale, mbrojtjen e konsumatorit dhe mbështetjen për inovacionin në sektorin postar, si dhe sigurimin e një sistemi të gjurmueshëm auditimi,


duke mundësuar mbrojtje më efektive të konsumatorëve dhe rritjen e besimit në aktivitetin e blerjeve online.

Brenda muajit mars 2026

5.2. Pyetje e auditimit: A janë procedurat e ndërmarra nga ana e institucioneve të mjaftueshme për formalizimin e kësaj veprimtarie?

Ministria e Financave veç rolit të vet të politik bërësit për politikat fiskale në vend është institucion i cili ka nën varësi Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të cilat janë institucionet kryesore për mbledhjen e të ardhurave në vend. Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut është gjithashtu si institucion zbatues i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimor të destinuara për konsumatorët. Ndërsa Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organ i pavarur i cili mbikëqyr kuadrin rregullator, të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, ligji për shërbimin postar, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Fig.2 “Sistemi për blerjet online”



Burimi: Grupi i auditimit.

Gama e blerjeve online përfshin si blerjet e kryera nëpërmjet platformave online nga jashtë vendit të cilat hyjnë në territorin vendas nëpërmjet shërbimit postar në rrugë ajrore, tokësore apo detare por edhe blerjet e kryera nëpërmjet platformave apo faqeve online brenda vendit. Nëpërmjet tyre konsumatorët blejnë mallra dhe shërbime të ndryshme.

Blerjet online nga jashtë vendit

Për të gjitha blerjet online të kryera jashtë vendit pjesa më e madhe e tyre vijnë në vendin tonë nëpërmjet transportit ajror dhe pikërisht Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”. Pranë këtij aeroporti funksionon një degë doganore e veçantë “Dega Doganore Rinas”, e cila përpunon dërgesat e mbërritura nëpërmjet 2 kompanive postare, përkatësisht DHL dhe UPS. Të gjitha dërgesat e tjera përpunohen në Qendrën e Tranzitit pranë Degës Doganore Tiranë.

Kuadri ligjor për importet

VKM nr. nr.919, datë 29.12.2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, deri në vitin 2016 ka patur një kufi prej **150 euro** për importin e mallrave me karakter jo tregtar, të pataksueshme, të cilat bliheshin nëpërmjet internetit, apo i dërgoheshin një personi nga një person tjetër i vendosur jashtë Republikës së Shqipërisë.

Me ndryshimet e ndodhura në vitin 2016 kufiri prej **150 Euro** ndryshoi në 2-fasha, në masën **22 Euro** për mallrat e blera nëpërmjet porosisë nga interneti, që importohen nëpërmjet dërgesave postare, dhe në masën **45 Euro** të pataksueshme, për dërgesat nga një individ jashtë Shqipërisë pranë një individ në territorin shqiptar, të një natyre rastësore, pa pagesë dhe që përmbajnë vetëm mallrat e destinuara për përdorim personal ose familjar prej marrësit.

Referuar projektvendimit përkatës, ky ndryshim kishte si qëllim uljen e kufirit të pa tatueshëm për dërgesat e mallrave me karakter jo tregtar, të cila kanë një vlerë të ulët dhe objektivi që synohet të arrihet është përafrimi i direktivave të BE-së, konkretisht Direktivës 2009/132/EC dhe Direktivës 2006/79/EC.

Në vitin 2017 kuadri ligjor për importet ka pësuar ndryshime pasi ka hyrë në fuqi VKM-ja e re nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i cili në nenin 420 ruan të njëjtën linjë me VKM e mëparshme sa i takon dërgesave me vlerë të papërfillshme me karakter jo tregtar.

Në vijim të VKM nr. 421, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka nxjerrë udhëzimet përkatëse dhe konkretisht.

-Udhëzimin nr. 2 datë 15.01.2018 Deklarimi i mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje online me qëllim thjeshtëzimin, standardizimin dhe përfshirjen në sistemin kompjuterik doganor të procedurave për deklarimin në doganë të mallrave me natyrë jotregtare nga individë, vlera e të cilave tejkalon kufirin e vlerës së përshtuar nga detyrimet në import.

- Mbi 22 euro për blerjet online
- Mbi 45 euro për dërgesat postare ndërmjet individëve

Për dërgesat më sipër administrata doganore përdor deklaratë të thjeshtuar importi dhe në fund të ditës bëhet një deklaratë përmbledhëse për regjimin IM4.

- Nëse vlera është mbi 1,000 euro përdoret deklarata e importit IM 4 (DAV).

-Udhëzimin nr. 2 datë 01.03.2019, nëpërmjet të cilit janë bërë disa ndryshime në Udhëzimin nr. 2 të vitit 2018 sa i takon mallrave me vlerë të papërfillshme, duke saktësuar se për efekt të përjashtimit në vlerën 22 euro do të përfshihet vetëm çmimi i paguar për mallin dhe jo shpenzime të tjera si shpenzime transporti, siguracione etj.

-Udhëzimin nr. 2 datë 11.03.2024, nëpërmjet të cilit DPD ka saktësuar procedurat e thjeshtuara për mallrat që importohen/eksportohen nëpërmjet postës së shpejtë.

Nëpërmjet këtyre udhëzimeve DPD udhëzon strukturat doganore mbi zbatimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor ku përcaktohet gjithashtu se për çdo dërgesë (pako) përdoret Moduli për deklarimin e thjeshtuar të mallrave me natyrë jo tregtare, nëpërmjet të cilit kyhet deklarimi i thjeshtuar për çdo dërgesë dhe në fund të ditës për to nga sistemi mundësohet gjenerimi i një deklarate doganore përmbledhëse Import nr. 4 (IM4).

Përpunimi i Dërgesave online nëpërmjet transportit ajror, është pjesërisht i automatizuar.

Referuar të dhënave të marra nga DPD mbi ndryshimet në strukturën e Degës Doganore Rinas për periudhën 01.01.2020-31.12.2024 rezulton se ka një staf prej 45 punonjësish në strukturë por situata në fakt paraqitet me 2 punonjës më pak.

Struktura e personelit për DD Rinas
<ul style="list-style-type: none"> • Kryetari i Degës Doganore (1); • Zyra e Administratës (4); • Sektori Kargo (7) • Sektori Operacional në Terminal (33)
<ul style="list-style-type: none"> • Giithsej 45 personel

Situata në fakt
<ul style="list-style-type: none"> • Kryetari i Degës Doganore (1); • Zyra e Administratës (3); • Sektori Kargo (7) • Sektori Operacional në Terminal (32)
<ul style="list-style-type: none"> • Giithsej 43 personel

Struktura e cila merret drejtpërdrejtë me procesin e zhdoganimit të blerjeve online është Sektori i Kargos dhe konkretisht 2 doganierët e regjimeve që përpunojnë të gjitha deklaratat e thjeshtuara në sistemin informatik doganor, të cilët asistohen në këtë veprimtari nga 2 doganierë të kontrollit fizik.

Procesi lidhur me blerjet online ndjek këtë rrugë:

Fillimisht hidhet në sistemin Asycuda manifesti elektronik i të dhënave në të cilën renditen 2 kategoritë e dërgesave postare.

Kategoria 1: në të cilën janë mallrat mbi vlerën 22 Euro;

Kategoria 2: mallrat nën vlerën 22 Euro që konsiderohen vlera të papërfillshme.

Pas validimit të manifestit, agjencia doganore përkatëse bën llogaritjet për secilën dërgesë. Ndërkohë që pritësi i dërgesës duhet të kryejë pagesën në bankë të detyrimit doganor (në rast se ka) dhe nga agjencia hartohet deklarata doganore e thjeshtuar. Pasi ky proces përfundon dhe deklarata hidhet në sistem, bëhet kontrolli i dokumentacionit të deklaratës doganore dhe ai fizik. Theksojmë se për të gjitha dërgesat postare të cilat vijnë nga jashtë vendit kryhet skanimi i tyre.

Foto nr.1 Procesi i skanimit individual pranë Degës Doganore Rinas.



Burimi: Grupi i auditimit

Problematikë paraqitet mos hartimi i një DAV standard, e cila sjell dhe mbingarkesë pune në stafet që mbulojnë këto procese pasi procedurat për përpunimin e dërgesave postare në këtë Degë Doganore janë gjysmë të automatizuara dhe të gjitha dërgesat e manifestit elektronik pas mbylljes së deklaratës doganore shkarkohen manualisht. Në përgjigjen e saj Administrata Doganore është përgjigjur se, në bashkëpunim me UNCTAD po punon për të vënë në zbatim deklarinimin e parambërritjes për mallrat e hyra në rrugë ajrore. Kjo do të shkurtojë kohën e zhdoganimit të mallrave pasi analiza e riskut do të kryhet para se mallrat të mbërrijnë në territorin shqiptar. Por vënia në zbatim e kësaj procedure të thjeshtuar varet dhe nga zhvillimet IT të operatorit postar.

Për periudhën vitet 2020-2024 deklaratat e përpunuara nga Dega Doganore Rinas dhe rivlerësimet e kryera paraqiten si më poshtë:


Deklarata të përpunuara nga DD Rinas për blerjet online	
•Viti 2020	janë përpunuar 28,261 Deklarata
•Viti 2021	janë përpunuar 28,642 Deklarata
•Viti 2022	janë përpunuar 28,041 Deklarata
•Viti 2023	janë përpunuar 30,770 Deklarata
•Viti 2024	janë përpunuar 50,299 Deklarata

Rivlerësimet të kryera nga DD Rinas për blerjet online	
•Viti 2020	janë rivlerësuar 58 Deklarata
•Viti 2021	janë rivlerësuar 100 Deklarata
•Viti 2022	janë rivlerësuar 54 Deklarata
•Viti 2023	janë rivlerësuar 3 Deklarata
•Viti 2024	janë rivlerësuar 7 Deklarata

Burimi: DD Rinas e përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi rezultoi se numri i deklaratave të përpunuara në DD Rinas gjatë vitit 2024 ka arritur në 50,299 duke evidentuar një rritje të lartë në raport me vitin 2020 gjatë të cilit janë përpunuar 28,261 deklarata.

Grafiku nr.1 Paraqitja grafike e ecurisë së dërgesave të përpunuara gjatë periudhës 2020-2024 nga DD Rinas.



Burimi: DD Rinas e përpunuar nga Grupi i Auditimit

Numri i dërgesave të përpunuara gjatë vitit 2024 ka shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2020, duke u rritur me rreth 78%.

Nga auditimi rezultoi se në Degën Doganore Rinas nuk janë kryer ndryshime të qenësishme në përbërjen e stafit që prej vitit 2006, ndërkohë që volumi i punës ka njohur rritje të ndjeshme. Aktualisht, numri i deklaratave të thjeshtuara paraqitet rreth 30 mijë në vit, ndërsa fluksi i fluturimeve ajrore në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit është rritur mbi pesëfish gjatë së njëjtës periudhë. Kjo situatë nënvizon nevojën për një vlerësim gjithëpërfshirës të kapaciteteve njerëzore nga DPD, me qëllim sigurimin e efikasitetit operacional dhe cilësisë së shërbimit.

Dega Doganore Tiranë nuk disponon pajisje për të kryer skanim në mënyrë individuale të dërgesave.

Veç rrugës ajrore dërgesat vijnë edhe në rrugë detare e tokësore, ku në secilën pikë doganore hyrëse bëhet skanimi në total i tyre dhe kalojnë për në Qendrën e Tranzitit, e cila mbikëqyret nga Dega Doganore Tiranë.

Strukturat doganore që mbikëqyrin lëvizjen e mallrave të blera online dhe që kryejnë veprimet në Modulin e Zhdoganimit të Thjeshtuar, është Zyra e Magazinimit të Përkohshëm që përbëhet nga 5 persona (1 shef zyre dhe 3 specialistë), si edhe një doganier i atashuar pranë Drejtorisë së Postës Shqiptare.

Foto nr.2 Procesi i skanimit individual pranë Qendrës së Përkohshme të Postës Shqiptare.



Burimi: Grupi i auditimit

Operatorët postarë që operojnë pranë Degës së Doganës Tiranë, të cilët kryejnë veprime pranë kësaj Dogane janë “U. E.” (F.E.), Posta Shqiptare, si edhe për blerjet nga Kosova operatorët P., B., A.D.E. dhe U.C.E.P. etj. Për të gjithë operatorët janë të miratuara procedurat e deklarimit në Modulin e deklarimit të thjeshtuar për dërgesat postare online. Ndryshe nga procedurat e deklarimit të blerjeve online në Degën Doganore Rinas, në këtë degë doganore procedurat janë të informatizuara.

Ndërkohë sa i përket skanimit të pakove individuale ai kryhet vetëm për dërgesat postare që kryhen nga Posta Shqiptare, ndërsa për dërgesat që kryhen nga operatorët e tjerë postarë skanimi dhe peshimi i mjetit që transporton pakot postare kryhet vetëm në momentin e hyrjes në territorin shqiptar në procesin e skanimit të gjithë ngarkesës dhe jo si pako individuale, çka nuk i mundëson administratës doganore të evidentojë përmbajtjen e saj dhe të ushtrijë në mënyrë më objektive funksionet e saj vlerësuese.

Disa nga problematikat e konstatuara nga Dega Doganore Tiranë gjatë procedurës së mbikëqyrjes së lëvizjes së dërgesave postare të blera online janë:


- ✓ kanë rezultuar raste të mospërputhjes së emërimit dhe sasisë së mallit të deklaruar, me atë që përmban pako postare,
- ✓ kanë rezultuar në sasi të vogla produkte të ndryshme si “parfum”, “ujë tualeti”, “kafe”, të cilat nuk mund të deklarohen në Modulin e deklarimit të thjeshtuar,
- ✓ kanë rezultuar mallrat e deklaruar si blerje online për përdorim personal, por që nga verifikimi i sasive e llojit të produkteve që përmban pako, lindin dyshime të arsyetuara që janë për qëllime tregtimi, në këto raste janë kryer procedurat e deklarimit normal për qarkullim të lirë.

Mungon një manual i posaçëm për menaxhimin e riskut në trajtimin e dërgesave postare për individët dhe subjektet tregtare.

Vlerësimi i riskut për vitet 2020 – 2024 është kryer referuar Manualit Udhëzues nr. 02, datë 31.03.2016, “Mbi Menaxhimin e riskut dhe të drejtën e kontrollit bazuar në analizën e riskut” miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Duke qenë se në deklaratimet e thjeshtuara nuk funksionojnë profilet e riskut si ato të deklaratës IM4, por ato paraqiten vetëm në momentet e hartimit të deklaratës përmbledhëse. Dokumentacioni dhe sqarimet mbi rezultatet e verifikimit për praktikën e përzgjedhura me risk, pasqyrohen në deklaratën përmbledhëse të deklaratave të thjeshtuara, pra pasi kanë përfunduar të gjitha procedurat individuale dhe mallrat janë çliruar

për qarkullim. Risku për këtë lloj deklarimi nga administrata doganore kryhet mbi bazën e riskut lokal të vlerësuar nga autoritetet doganore, bazuar kjo në profilet rastësore.

Grafiku nr. 2 Të dhënat mbi sasi të zhdoganuara në vite (2019-2024)



Burimi: DPD përpunuar nga grupi i auditimit.

Sikundër vihet re nga grafiku i mësipërm sasia e zhdoganimeve sipas peshës së dërgesave ka patur një rritje gjatë vitit 2024 rreth 110% në raport me vitin 2022.

Ndërkohë që administrata doganore po përballet me fluks të shtuar të dërgesave, staf të reduktuar dhe e detyruar të zhvillojë risk në nivel lokal, mungesa e një skaneri ndikon kohën e përpunimit të dërgesave dhe vlerësimin objektiv të tyre. Administrata doganore mbi bazën e të dhënave që akseson nuk arrin të përpunojë të dhënat e blerësve individë, çka e kufizon atë në vlerësimin e riskut lokal.

Përveç problematikave të shprehura më sipër nga auditimi rezulton se nuk ka të dhëna për kryerjen e verifikimeve/kontrolleve për zhdoganimet e blerjeve online nga ana e grupeve të lëvizshme të antikontrabandës me qëllim garantimin e një niveli më të lartë kontrolli.

Mungon një kod specifik për klasifikimin e shërbimeve të ofruara online në nomenklaturën e veprimtarive ekonomike.

Ndryshe nga dërgesat e ardhura nga jashtë vendit të cilat kalojnë filtrat e kontrollit në pikat kufitare dhe doganore, aktiviteti i shitjeve online brenda vendit paraqitet më kompleks. Për të mbikëqyrur aktivitetin disa institucione ligj zbatuese sipas fushës së tyre të përgjegjësisë ushtrojnë kontroll dhe mbikëqyrje të këtij tregu dhe transaksioneve që kryhen në të.

Një nga institucionet e rëndësishme në këtë drejtim është edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, institucion qendror në varësi të Ministrit të Financave si autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve. Ajo organizohet në nivel qendror dhe rajonal. Funkcionet dhe detyrat e DPT, drejtorive rajonale, të secilës drejtori, si dhe të njësive të tjera të administratës tatimore qendrore përcaktohen me rregullore të brendshme, e cila propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe miratohet nga Ministri i Financave, të cilat janë të miratuara prej vitit 2020 përkatësisht me Urdhrat e Ministrit nr. 192 dhe nr. 193 datë 12.08.2020.

DPT disponon një kuadër ligjor përgjithësisht të konsoliduar për procedurat tatimore i cili daton prej vitit 2008 dhe ka pësuar ndryshime gjatë 16 viteve të fundit.

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008, për zbatimin e tij, janë pikërisht udhërrëfytes veprimi për subjektet tregtare, individët që kryejnë veprimtari apo realizojnë të ardhura, si dhe organet tatimore të cilët ushtrojnë kompetencat mbi bazën e tij.

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga ana e DPT, në fund të vitit 2024 janë gjithsej 594 subjekte tregtare, të cilët ushtrojnë aktivitetet në fushën e tregtisë online në vend. Ndërkohë që totali i tatimpaguesve të regjistruar për të gjitha llojet e aktiviteteve, për të njëjtën periudhë sipas këtij institucioni paraqitet 134,936 subjekte.

Nga ana tjetër sipas të dhënave të disponuara nga AKEP rezultoi se është një numër i lartë tatimpaguesish të cilët disponojnë *domainin .al*, i cili administrohet nga AKEP. Ky numër mund të jetë edhe më i lartë, pasi për këtë aktivitet mund të përdoren edhe domaine të tjerë të cilët nuk administrohen prej këtij institucioni.

Më poshtë paraqesim të dhënat e disponuara nga të dy institucionet deri në 31.12.2024.

Subjekte të regjistruar në fushën e tregtisë online sipas DPT	Subjekte të cilat disponojnë domain .al (AKEP)
<ul style="list-style-type: none"> • 482 subjekte me veprimtari Tregti online • 16 subjekte me veprimtari Aktivitete të postave me detyrimin e shërbimit të përgjithshëm • 96 subjekte me veprimtari Aktivitete të tjera postare dhe të korrierit 	<ul style="list-style-type: none"> • regjistruar deri në vitin 2019 6,504 • regjistruar gjatë vitit 2020 1,215 • regjistruar gjatë vitit 2021 1,334 • regjistruar gjatë vitit 2022 1,566 • regjistruar gjatë vitit 2023 2,008 • regjistruar gjatë vitit 2024 6,016
<ul style="list-style-type: none"> • Gjithsej subjekte 594 për tregëtinë online 	<ul style="list-style-type: none"> • Gjithsej të regjistruar në AKEP 18,643 domaine

Burimi: DPT, AKEP, përpunuar nga grupi i auditimit.

Referuar edhe sa më lart DPT në përgjigjet e saj evidenton se referuar VKM nr. 320, datë 28.5.2014, “Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të revizionuara (REV.2), nuk ka një përcaktim të qartë për shërbimet online nëpërmjet platformave. Në këtë nomenklaturë aktivitetesh janë aktualisht dy kode të cilat përfshihen në tregtinë online dhe përkatësisht:

- ✓ kodi 4791: Tregtia me pakicë me porosi me mail ose nëpërmjet internetit;
- ✓ kodi 5621: Katering me porosi për raste.

Mungesa e një kodi specifik për tregtinë online në nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të revizionuara, mund të mos lejojë për caktimin e një kriteri rrisht për këtë veprimtari.

Planifikimi i tatimpaguesve për kontroll në këtë institucion, sipas bazës ligjore dhe manualeve përkatëse, kryhet bazuar në kriteret e përcaktuara nga rrishtu dhe kalohet në komitetin e rrishtu për miratim, çdo muaj. Për pasojë përzgjedhja për kontroll e tatimpaguesve që ushtrojnë veprimtarinë në tregtinë online nuk mund të planifikohet në kushtet e mungesës së një kriteri të përcaktuar rrishtu.

Paqartësia në ushtrimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren për verifikimin në terren të subjekteve tregtare.

Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (DVKT) në administratën tatimore është struktura e cila kryen verifikimet në terren nëpërmjet strukturave të veta në rajone të cilat operojnë si njësi më vete nga ana logjistike ndërsa për zbatimin e detyrave të tyre funksionale kanë varësi hierarkike nga Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT.

Verifikimet në terren kryhen nga DVKT-ja përkatëse sipas DRT-së që ka nën juridiksion në zbatim të planeve operacionale të miratuara nga DPT, kryesish në, trajtimin e listave të ardhura nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe trajtimi i denoncimeve, emaileve dhe shkresave të ardhura në drejtori. Pra kjo strukturë aktualisht operon vetëm mbi bazë planesh me bazë risku apo denoncimesh apo të dhënash nga institucionet të tjera ligjzbatuese. Lidhur me tregtinë online, veprimtaria e këtyre strukturave thuhet se mungon pasi nuk disponohet logjistika, kapacitet njerëzor, trajnimet e nevojshme për kontroll.

Brenda strukturës së Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në DPT gjendet Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit në Terren (Task-Forcë). Kjo strukturë referuar Rregullores së DPT neni 136-141 dhe vijues të tij, ka si detyrë monitorimin e strukturave në rajone por gjithashtu kryen edhe verifikime më vete në subjekte tregtare veprimtari kjo që nuk lejohet nga Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, referuar pikës nr. 14.2. *Përgjegjësitë dhe funksionet kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve* e cila parashikon se: pika 16, *njësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në asnjë rast, nuk lejohet të kontrollojnë direkt tatimpaguesit.*

Rregullorja e brendshme e DPT, miratuar po nga Ministri përgjegjës për financat me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, parashikon edhe dokumentacion që përdoret në verifikimet në subjektet tregtare. Ndërkohë, Manuali i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me Urdhrin nr. 19/2, datë 28.04.2020 përshkruan njëlloj veprimtarinë e strukturave të verifikimit në terren në rajone me ato të Strukturës Task-Forcë në DPT. Ndërkohë që këto struktura duhet të kenë si qëllim parësor verifikimin e punës së strukturave në rajone dhe jo të jenë njësi zbatuese paralel me strukturat rajonale të juridiksionit. Evidentohet gjithashtu se në UMF nr. 24 datë 02.09.2008 nuk janë reflektuar ndryshimet e ndodhura në Ligjin nr. 9920, sa i përket strukturave të hetimit, veprimtarive operacionale, kontrolluese etj, çka paraqet nevojën për më tepër vëmendje nga strukturat përgjegjëse për harmonizimin në kohë të tyre.

Institucionet objekt auditimi, nuk kanë parashikuar fushata sensibilizuese lidhur me tregtinë online

Në raportet vjetore të Inspektoratit Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimor të destinuara për konsumatorët, evidentohen problematika vit pas viti lidhur me fushën e blerjeve online, si mungesa e të dhënave NUIS dhe adresa të subjekteve shitës në faqet online. Për vitet 2020-2024 drejt këtij institucioni janë referuar 40 ankesa të konsumatorëve lidhur me blerjet online të cilat kanë qenë kryesisht për blerje veshjesh, pajisjesh elektro-shtëpiake, lodra për fëmijë, aksesore personal etj. Vetëm 25% e ankesave rezultojnë të ketë gjetur zgjidhje nga ky institucion për mungesë të të dhënave të sipër përmendura.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, nuk shqyrton përmbajtjet e komunikimeve elektronike dhe as përmbajtjet e publikuara në faqet e internetit, rrjetet sociale, platformat online, etj. Ky institucion nuk kryen identifikimin dhe as bllokimin e faqeve. Identifikimi i tyre kryhet nga institucione ligj zbatuese, që e kanë një kompetencë të tillë ligjore, të tilla si organet gjyqësore, organet e ndjekjes penale, Autoriteti i Mediave Audio-vizive, Autoriteti për Mbikëqyrjen e Lojërave të Fatit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe të Drejtën e Informimit, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, etj.,

Referuar gurmës e), të nenit 15, të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, çdo operator/sipërmarrës që ofron shërbime/rrjete të komunikimeve elektronike, sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, duhet të respektojë kufizimet e transmetimeve të përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme. Bazuar në këto dispozita AKEP përcjell tek sipërmarrësit që

ofrojnë shërbimin internet (ISP) në Republikën e Shqipërisë kërkesat e Autoriteteve kompetente ligj zbatuese për mbyllje domainesh, faqesh interneti, linke specifike, të konstatuara në shkelje ligjore nga këto institucione. Mbyllja e aksesit nga ISP-të ka efekt vetëm në Republikën e Shqipërisë dhe jo jashtë saj. Në çdo rast nuk kryhet mbyllje e domainit, por mbyllje e aksesit të domainit. Pra, përmbajtja e ofruar në atë domain bëhet e pa aksesueshme nga ISP-të shqiptare për pajtimtarët e tyre të internetit.

Gjithashtu, mungesa e një mekanizmi kufizues për faqet online të paregjistruara ka penguar formalizimin e tregut, duke krijuar pasiguri për konsumatorët në lidhje me cilësinë dhe sigurinë e produkteve apo shërbimeve të blera. Kjo situatë rrezikon transparencën dhe konkurrencën e drejtë në tregun online, si dhe cenon mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit.

Referuar sa më sipër vlerësohet nevoja për rishikimin e bazës ligjore aktuale në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” për të mundësuar detyrimin e subjekteve tregtare që ushtrojnë veprimtari tregtare së pari për publikimin e të dhënave identifikuese të biznesit dhe së dyti për mundësimin e një mekanizmi për tu drejtuar AKEP për bllokimin e faqeve të cilat nuk kryejnë këtë publikim. Këto masa të kenë si qëllim rritjen e transparencës, uljen e informalitetit në këtë sektor.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dërgesave online në Degën Doganore Rinas u konstatua se proceset aktuale për përpunimin e dërgesave mbeten gjysmë të automatizuara, pasi një pjesë e konsiderueshme e procedurave kryhet manualisht nga një staf i kufizuar, i cili përballet me mbingarkesë operacionale. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së një moduli funksional për deklarimin para mbërritjes së mallrave hyrë në rrugë ajrore, duke penguar analizën paraprake të riskut dhe zgjatur kohën e zhdoganimit.

Gjithashtu nga auditimi rezultoi mungesë e menaxhimit të burimeve njerëzore në strukturimin e proceseve për përpunimin e dërgesave, e cila ndikon në cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve, si dhe në efektivitetin e mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi dërgesat online, duke krijuar në këtë mënyrë sfida operacionale në menaxhimin e volumit në rritje të tregtisë elektronike.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Dega Doganore Tiranë nuk disponon një pajisje për të kryer skanim në mënyrë individuale për secilën pako ndryshe nga procedura që kryen Posta Shqiptare dhe Dega Doganore Rinas, të cilat e zotërojnë një të tillë. Moskryerja e procesit të skanimit individual të pakove kufizon vlerësimin e saktë të përmbajtjes së dërgesave, duke krijuar pasiguri dhe vonesa në proceset doganore. Kjo ndikon gjithashtu në efikasitetin e kontrollit dhe në transparencën e vlerësimit të mallrave.

Konkluzion 5: Mungesa e skanerit në Degën Doganore Tiranë kufizon mundësinë e vlerësimit të përmbajtjes së pakove, duke ndikuar në efektivitetin e analizës së riskut nga autoritetet doganore. Ky hendek në kapacitetet teknologjike mund të krijojë pasiguri në monitorimin dhe kontrollin e dërgesave.

7. Gjetje nga auditimi: Administrata doganore nuk ka ende një manual të posaçëm për menaxhimin e riskut në trajtimin e dërgesave postare për individët dhe subjektet tregtare. Aktualisht, sistemi i operimit me deklaratë përmbledhëse nuk lejon vlerësimin e riskut në mënyrë të automatizuar, duke mos mundësuar evidentimin e rasteve kur mallrat janë rivlerësuar nga autoritetet doganore dhe klasifikimin e tyre sipas profileve të riskut. Megjithëse, Drejtoria Anti-Korrupsion dhe Standardeve Profesionale ka rekomanduar që në deklaratën përmbledhëse IM4 të ndahen deklaratat e thjeshtuara (një Bis për çdo deklaratë), ky standard ende nuk është zbatuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Mungesa e këtij mekanizmi rrezikon të ulë efektivitetin e analizës së riskut dhe mbikëqyrjen e duhur të dërgesave postare.

Konkluzion 6: Mungesa e një manuali të posaçëm për menaxhimin e riskut dhe përdorimi i deklaratës përmbledhëse pa klasifikim, sipas profileve të riskut e kufizojnë efektivitetin e administratës doganore në trajtimin e dërgesave postare. Përmirësimi i sistemit të deklarimit dhe implementimi i një mekanizmi të automatizuar të vlerësimit të riskut do të forcojë transparencën dhe mbikëqyrjen, duke mundësuar një proces doganor më të saktë dhe efikas.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se VKM nr. 320, datë 28.5.2014, “Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të revizionuara (REV.2)” nuk ka një përcaktim të qartë për shërbimet online nëpërmjet platformave. Tregtia online përballet me probleme në identifikimin dhe kontaktimin e subjekteve që operojnë në këtë sektor, për shkak të mungesës së një kodi specifik për klasifikimin e shërbimeve të ofruara. Për më tepër, faqet online nuk përmbajnë të dhëna të qarta mbi regjistrimin e tatimpaguesve, duke e bërë të vështirë monitorimin e tyre nga autoritetet.

Konkluzion 7: Mungesa e një kodi specifik për klasifikimin e shërbimeve ka ndikuar në vështirësinë e identifikimit dhe kontaktimit të subjekteve aktive në këtë sektor, duke krijuar një mjedis të paqartë për autoritetet mbikëqyrëse. Për më tepër, fakti që faqet online nuk përmbajnë të dhëna të qarta mbi regjistrimin e tatimpaguesve e bën të pamundur monitorimin efektiv dhe kontrollin fiskal të veprimtarive tregtare. Për të adresuar këto problematika, është thelbësore hartimi i politikave të mirëpërcaktuara për rregullimin e tregtisë online, përmirësimi i mekanizmave të identifikimit të subjekteve dhe forcimi i kontrollit institucional për të siguruar një mjedis më transparent dhe të mbrojtur për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Institucionet objekt auditimi nuk kanë parashikuar fushata sensibilizuese lidhur me tregtinë online, në kushtet kur ky treg paraqitet në rritje të vazhdueshme. Institucionet nuk kanë arritur të shfrytëzojnë për këtë qëllim dhe mundësitë e publikimit të shpjegimeve për këtë veprimtari në faqet e tyre online, lidhur me mënyrën e funksionimit të kësaj veprimtarie referuar kuadrit ligjor e rregullator në fuqi.

Konkluzion 8: Fushatat sensibilizuese për blerjet online janë të rëndësishme sepse ndihmojnë në informimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke i pajisur ata me njohuri mbi të drejtat e tyre, rreziqet e mundshme dhe mënyrat për të bërë blerje të sigurta. Këto fushata luajnë një rol kyç në uljen e informalitetit dhe në rritjen e transparencës në tregun online, duke i bërë konsumatorët më të vetëdijshëm për praktikatat e ndershme tregtare dhe për mekanizmat e mbrojtjes ligjore.

10. Gjetje nga auditimi: Seksioni Task-Forcë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ushtron të drejtë të verifikimit në terren në subjekte të ndryshëm tregtarë referuar, Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 192 datë 12.08.2020, si dhe Manualit të Punës miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ndërkohë sipas Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 14.2.16 e tij, kontrolli në vend i tatimpaguesve nga njësitë qendrore nuk lejohet, duke sjellë në këtë mënyrë paqartësi në veprimtarinë e verifikimit në terren të subjekteve tregtare.

Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008, përveç mungesës së harmonizimit me aktet e mësipërm rregullatorë, nuk reflekton edhe ndryshimet e ndodhura në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sa i përket strukturës së Hetimit Tatimor, funksioneve bazë dhe operacionale të strukturave, etj.

11. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve zbaton një sistem përzgjedhjeje të tatimpaguesve për kontroll bazuar në analizën e riskut, e cila miratohet çdo muaj nga Komiteti i Riskut. Veprimtaria e tregtisë elektronike nuk është e përfshirë në mënyrë të dedikuar në këtë sistem, pasi mungon një kriter specifik risku për këtë sektor.

Struktura përgjegjëse për verifikimet në terren, Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, operon kryesisht mbi bazën e listave të përzgjedhura nga DPT, denoncimeve të ardhura nga qytetarë apo institucione të tjera

Aktualisht, nuk kryhen verifikime proaktive në terren për subjektet që operojnë në tregtinë online, përveç rasteve të denoncuara duke sjellë në këtë mënyrë mungesë të mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të një sektori me rritje të shpejtë dhe informalitet të lartë, si edhe rrezik të shtuar për shmangie fiskale, për shkak të mungesës së fiskalizimit dhe përdorimit të pagesave “cash on delivery”.

Në mungesë të një profili risku të dedikuar për tregtinë online, administrata tatimore nuk ka një mekanizëm të strukturuar për përzgjedhjen dhe kontrollin sistematik të këtyre tatimpaguesve, duke e lënë këtë sektor jashtë mbikëqyrjes efektive.

Konkluzioni 9: Procedurat e ndërmarra nga ana e institucioneve përgjegjëse nuk kanë qenë të mjaftueshme për formalizimin e tregtisë online, e cila paraqitet me një trend rritës të vazhdueshëm.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa për automatizimin e plotë të procesit të përpunimit të deklaratave doganore, duke reduktuar ndërhyrjet manuale dhe mbingarkesën operacionale të stafit nëpërmjet integritimit të një sistemi dixhital.

Brenda muajit mars 2026

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa për plotësimin me personel të Degës Doganore Rinas në Sektorin Kargo, duke u bazuar në analizë volumi, fluksi operativ dhe objektivat e dixhitalizimit të procedurave doganore, me synim rritjen e numrit të punonjësve të specializuar për përpunimin e dërgesave online, përsheptimin e procedurave, përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe sigurinë e mbikëqyrjes.

Brenda muajit mars 2026

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa, për të mundësuar vlerësimin e saktë të përmbajtjes së dërgesave, për të mos krijuar pasiguri dhe vonesa në proceset doganore.

Brenda muajit mars 2026

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të hartojë dhe miratojë një manual/udhëzues të standardizuar për vlerësimin e riskut në trajtimin e dërgesave postare, duke përcaktuar qartë metodologji të detajuara për identifikimin, kategorizimin dhe menaxhimin e risqeve. Manuali duhet të përcaktojë kritere të qarta për kontrollin e dërgesave, duke integruar praktikën e mira ndërkombëtare dhe harmonizimin me legjislacionin e BE-së, për të garantuar në këtë mënyrë një proces transparent dhe të sigurt.

Brenda muajit qershor 2026

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për unifikimin dhe standardizimin e deklaratave përmbledhëse, duke garantuar një Bis për çdo deklaratë, me qëllim vlerësimin automatik të riskut sipas profileve, gjurmueshmëri të dërgesave, unifikimin e vlerësimeve doganore lidhur me dërgesat postare nga jashtë vendit, si dhe shmangien e abuzimeve.

Brenda muajit mars 2026

7.3. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për trajnimin e stafit doganor në zbatimin praktik të manualit të vlerësimit të riskut, në përdorimin e sistemeve dixhitale për përpunimin e dërgesave, si dhe në standardizimin e deklaratës përmbledhëse përmes një BIS unik, me qëllim reduktimin e pasigurive në zbatimin e procedurave dhe rritjen e efektivitetit dhe transparencës së procesit doganor.

Pas miratimit të manualit të vlerësimit të riskut

8.1. Rekomandimi: Ministria e Financave në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, të propozojnë dhe miratojnë përditësimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike (REV.2)³³ me një kategori/kod të veçantë për shërbimet tregtare të ofruara nëpërmjet platformave elektronike dhe online, në përputhje me sistemin ndërkombëtar NACE Rev.2³⁴ dhe standardet e OKB-së për klasifikimin e shërbimeve

Brenda muajit mars 2026

8.2. Rekomandimi: Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrin nismat e nevojshme ligjore për ndryshimin e Ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, duke përfshirë:

Përcaktimin e përkufizimit të aktivitetit të tregtisë elektronike, në përputhje me legjislacionin e BE-së (Direktiva 2000/31/EC);

Vendosjen e detyrimit ligjor për publikimin e të dhënave të regjistrimit tatimor (NIPT, emër biznesi, seli, kontakt) në çdo faqe apo platformë që ofron shërbime ose produkte online;

Përfshirjen e një dispozite që i jep të drejtë administratës tatimore t’i drejtohet AKEP, për pezullimin e përkohshëm të një faqeje online në rastet kur nuk përmbushen detyrimet e transparencës për regjistrimin dhe statusin tatimor.

Brenda muajit mars 2026

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të marrin masa për sensibilizimin për tregtinë online, me qëllim për të bërë sa më transparente dhe të kuptueshme mënyrën e funksionimit të kësaj veprimtarie, si dhe të drejtat e detyrimet të subjekteve tregtarë të cilët operojnë në këtë fushë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.1. Rekomandimi: Ministria e Financave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të rishikojë dhe harmonizojë Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Manualin e Drejtorisë së Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, me qëllim përafrimin e veprimtarisë së Sektorit të Verifikimit dhe Monitorimit në Terren (Task-Forcë) në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Brenda muajit mars 2026

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të hartojë dhe zbatojë një profil të dedikuar risku për tatimpaguesit që operojnë në tregtinë elektronike, duke e integruar në sistemin e analizës së riskut, me qëllim përzgjedhjen sistematike për kontroll të subjekteve që ushtrojnë aktivitet tregtar online.

³³ Statistical Classification of Economic Activities in the European Community

³⁴ Statistical classification of economic activities

Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për zhvillimin e një metodologjie të posaçme për verifikimet në terren, të përshtatur për natyrën dixhitale të aktivitetit, përfshirë shitësit në rrjete sociale, platforma të pavarura dhe aplikacione të dedikuara;

Menjëherë dhe në vijimësi

5.3. Pyetje e auditimit: A ka funksionuar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve në fushën e blerjeve on-line për garantimin e qytetarit?

Mangësitë e theksuara në koordinimin institucional për mbikëqyrjen dhe formalizimin e tregtisë elektronike.

Mbrojtja e interesave të konsumatorëve në treg, përcaktimi i rregullave dhe ngritja e institucioneve përkatëse për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve si dhe përfshirja e të gjitha marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, që kanë të bëjnë me blerjet e mallrave apo shërbimeve, kryesisht rregullohen me Ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”³⁵ si dhe me disa dispozitat të tjera të përcaktuara në ligje apo akte nënligjore të veçanta.

Mbrojtja e konsumatorit, për çështje që lidhen me sigurinë e produkteve dhe shërbimeve të konsumatorëve, përfshin kryesisht mbrojtjen e interesave ekonomike, individuale apo kolektive dhe të drejtave të tjera të konsumatorëve, në aspektet e lidhura me politikën, legjislacionin dhe zbatimin e tij. Në terma më specifike ndër të tjera këtu përfshihen edhe çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e konsumatorëve në kontratat e shit-blerjeve të mallrave apo shërbimeve në largësi, ose e thënë ndryshe nëpërmjet tregtisë elektronike.

Rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, parë në kontekstin e mbrojtjes së interesave të konsumatorëve në treg, gjatë viteve të fundit kanë vijuar të jenë mbështetës të rëndësishëm të lehtësimit të komunikimit ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve nga përdorimi i platformave elektronike online të cilat kanë mundur ofrimin e shërbimeve të ekonomisë digjitale siç është edhe ajo e tregtisë elektronike.

Institucionet politikbërëse dhe agjencitë ekzekutive ligj zbatuese që ndërthuren me sistemin e tregtisë elektronike janë si më poshtë:

Ministria e Financave

Ministria që mbulon fushën e Ekonomisë (MEKI)³⁶

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Bashkëpunimi ndër-institucional midis institucioneve përgjegjëse, fusha e veprimtarisë së të cilave lidhet me blerjet online është thelbësor për të garantuar monitorimin efektiv dhe formalizimin e tregtisë online në Shqipëri.

Konkretisht shkëmbimi i të dhënave midis DPT dhe AKEP ndihmon në identifikimin e subjekteve që operojnë online pa u regjistruar si tatimpagues. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të luftuar evazionin fiskal dhe për të siguruar konkurrencë të ndershme.

AKEP luan një rol kyç në identifikimin e faqeve dhe platformave që ofrojnë shërbime tregtare online. Një bashkëpunim i mundshëm me DPT dhe ISHMT, do të mundësonte ndërtimin e një

³⁵ Ky ligj është përafuar pjesërisht, me: Direktivën 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 25 tetor 2011, “Mbi të drejtat e konsumatorit, e cila ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13/KEE dhe Direktivën 1999/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 85/577/KEE dhe Direktivën 97/7/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”, të ndryshuar.

³⁶ Ministria që mbulon fushën e ekonomisë, ka përgjegjësinë shtetërore të ushtrijë veprimtarinë që lidhet me fushën e mbrojtjes së konsumatorëve³⁶, regjistrimin dhe licencimin e operatorëve ekonomikë, etj. Ky institucion i ri i krijuar aktualisht mbulon fushën e ekonomisë e cila përpara vitit 2024 mbulohej nga ish Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe ish Ministria e Kulturës. Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut është institucion në varësi të saj i cili kryen inspektimet në drejtim të mbikëqyrjes së tregut të produkteve jo-ushqimore.

baze të dhënash të përbashkët për të gjurmuar aktivitetet tregtare dhe për të parandaluar evazionin fiskal.

DPD është institucioni që ndjek rrjedhën e mallrave që hyjnë në vend përmes porosive online. DPD ka akses në të dhënat e deklaratave doganore për mallrat që hyjnë në territorin shqiptar përmes platformave të tregtisë elektronike. Kjo i mundëson të identifikojë subjekte që operojnë në mënyrë të përsëritur, por që nuk janë të regjistruar si biznese. Përmes një bashkëpunimi me DPT dhe Inspektoratin e Mbikëqyrjes së Tregut, do të ishte i mundur ndërtimi i një profili të plotë për subjektet që importojnë mallra për shitje online, duke ndihmuar në këtë mënyrë në zbulimin e informalitetit, kontrollin e cilësisë së produkteve dhe ndjekjen e detyrimeve fiskale. Një bashkëpunim mes AKEP, DPT dhe DPD mund të kontribuojë në krijimin e një platforme të përbashkët digjitale për ndarjen e informacionit në kohë reale mbi porosinë, dërgesat dhe subjektet aktive në tregtinë online.

Bashkëpunimi ndërinstitucional nuk duhet parë vetëm në aspektin teknik, por edhe strategjik me synim ndërtimin e një tregu digjital të rregulluar, të sigurt dhe të drejtë.

Nga auditimi rezultoi se ka patur disa marrëveshje bashkëpunimi midis institucioneve të përfshira, si më poshtë vijojnë:

- Marrëveshja e bashkëpunimit midis DPT dhe DPD, lidhur në 19.06.2018, me qëllim bashkërendimin e veprimeve për sigurimin dhe shkëmbimin e informacioneve për të parandaluar dhe luftuar evazionin fiskal dhe aktivitetet e tjera të paligjshme, në funksion të përmirësimit të administrimit dhe mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe doganore.

- Marrëveshja e bashkëpunimit midis AKEP dhe DPT, (pa afat) lidhur në datën 04.10.2019 me qëllim ndërveprimin institucional për të shkëmbyer informacion dhe të dhëna sistematike që lidhet me sektorin e komunikimeve elektronike, në kuadër të forcimit të luftës kundër informalitetit, për të evidentuar subjektet e kryejnë aktivitet tregtar nëpërmjet tregtisë elektronike.

- Marrëveshja e bashkëpunimit midis AKEP dhe ISHMT, (me afat 3 vjeçar), lidhur në datë 16.01.2019, me qëllim mbikëqyrjen e tregut në fushën e tregtisë elektronike dhe shkëmbimin e informacionit sistematik apo dinamik mbi veprimtarinë respektive institucionale.

ISHMT dhe Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit janë dy institucionet kryesore ligj zbatuese që kanë përgjegjësi në fushën e mbrojtjes së konsumatorit për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore. Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit ka bashkëpunuar me ISHMT dhe i delegon asaj për shqyrtim të gjitha ankesat që lidhen me fushë veprimtarisë së saj, ku përfshihen edhe ankesat e konsumatorëve për sigurinë dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të blera nëpërmjet tregtisë online.

Ndërsa në lidhje me sektorin postar, nuk ka marrëveshje bashkëpunimi me Postën Shqiptare për shkëmbim informacioni për dërgesat postare që kryejnë subjektet dhe individët nëpërmjet tregtisë online.

12. Gjetje nga auditimi: Ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është lidhur marrëveshje bashkëpunimi³⁷, për bashkërendimin e veprimeve, sigurimin dhe shkëmbimin e informacioneve në kohë reale, si dhe mbështetje reciproke për të parandaluar dhe luftuar evazionin fiskal dhe aktivitetet e tjera të paligjshme, në funksion të përmirësimit të administrimit dhe mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe doganore. Megjithatë, kjo marrëveshje nuk parashikon shkëmbimin e informacionit lidhur me blerjet online nga importi, si për subjektet fizike dhe juridike, ashtu edhe për individët që kryejnë blerje online mbi kufirin prej 22 euro, siç përcaktohet në dispozitat zbatuese të Kodit

³⁷ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve datë 19.06.2018 (DPD nr.14355 prot, DPT nr.12819 prot), i ndryshuar,

Doganor. Mungesa e këtij shkëmbimi të informacionit krijon hapësira për informalitet dhe shmangie nga detyrimet fiskale.

13. Gjetje nga auditimi: Marrëveshja e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare³⁸ me qëllim vendosjen e një niveli të ri ndërveprimi institucional për të shkëmbyer informacion dhe të dhëna sistematike mbi veprimtarinë respektive, për forcimin e luftës kundër informalitetit të subjekteve që kryejnë veprimtari në fushën e tregtisë online nuk ka gjetur zbatim për periudhën objekt auditimi. Të dyja palët megjithëse janë angazhuar në këtë marrëveshje që ti vënë në dispozicion të njeri tjetrit informacion apo të dhëna reciproke që lidhen me kontrollin, verifikimin, mbikëqyrjen dhe inspektimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, nuk kanë shkëmbyer informacion/të dhëna për subjektet fizikë, juridikë dhe/ose individë, që ushtrojnë veprimtari përmes tregjeve online, ndërfaqeve elektronike dhe platformave dixhitale.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i marrëveshjes së bashkëpunimit³⁹, midis Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, e lidhur për periudhën 16.01.2019 – 15.01.2022, me qëllim shkëmbimin sistematik dhe dinamik të informacionit mbi veprimtarinë institucionale, përfshirë edhe fushën e tregtisë online, nuk është shfrytëzuar nga asnjëra prej palëve gjatë afatit të saj. Marrëveshja përcakton që palët duhet të shkëmbejnë periodikisht, çdo 4 muaj, informacione mbi bazat e të dhënave të operatorëve ekonomik, përfshirë NUIS-të që regjistrojnë domain.al ose nëndomain.al, operatorët me veprimtari tregtare online, si dhe listën e operatorëve në fushën e tregtisë online dhe medias elektronike. Gjithashtu me përfundimin e afatit të kësaj marrëveshjeje, nuk është lidhur ndonjë marrëveshje tjetër bashkëpunimi për shkëmbim periodik të informacionit në fushën e tregtisë online midis këtyre institucioneve.

15. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka bashkëpunuar dhe ndërvepruar institucionalisht me Postën Shqiptare për shkëmbim informacioni dhe të dhënash për dërgesat postare, që kryejnë subjektet dhe individët nëpërmjet tregtisë online, si për dërgesat e blera nga jashtë vendit dhe për shit-blerjet brenda vendit, në kuadër të luftës kundër informalitetit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka kryer analizë të detajuar të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve, për përcaktimin i shkaqeve të mos pajtueshmërisë me fokus të veçantë tatimpaguesit që operojnë në sektorin tregtisë online nëpërmjet aktiviteteve postare.

Konkluzion 10: Mangësitë e theksuara në koordinimin institucional për mbikëqyrjen dhe formalizimin e tregtisë elektronike, mungesa e shkëmbimit të informacionit mbi blerjet online nga importi, dërgesat postare dhe subjektet që operojnë në tregtinë dixhitale ka krijuar hapësira për informalitet dhe shmangie nga detyrimet fiskale. Mungesa e një metodologjie të qartë për monitorimin e operatorëve ekonomikë, që veprojnë në platformat elektronike ka dobësuar transparencën e tregut dhe ka limituar mbrojtjen e konsumatorëve.

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrin masa për të rishikuar dhe përmirësuar marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 19.06.2018, duke përcaktuar një mekanizëm të qartë të shkëmbimit të informacioneve për blerjet online mbi kufirin e 22 euro, si dhe identifikimin e subjekteve fizikë dhe juridike që

³⁸ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare datë 04.10.2019 (AKEP nr.2141 prot, DPT nr.18429 prot)

³⁹ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare datë 16.01.2019 (ISHMT nr.126 prot, AKEP nr.67 prot).

kryejnë këto transaksione, ashtu edhe për individët që kryejnë blerje sipas përcaktimeve në dispozitat zbatuese të Kodit Doganor.

Brenda muajit mars 2026

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të marrin masa të zbatojnë marrëveshjen e bashkëpunimit midis tyre, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave sistematike mbi veprimtarinë respektive, për forcimin e luftës kundër informalitetit të subjekteve që kryejnë veprimtari në fushën e tregtisë elektronike.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve t'i kërkojë në mënyrë periodike Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare marrjen e të dhënave dhe informacioneve në lidhje me përdoruesit e ndërfaqeve elektronike dhe platformave dixhitale të regjistruara në domain.al ose nëndomain.al. të cilët kryejnë veprimtari në fushën e tregtisë elektronike, me qëllim përdorimin e tyre në funksion të monitorimit dhe kontrollit të kësaj veprimtarie.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1. Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të marrin masa për të lidhur një marrëveshje ndërmjet tyre, me qëllim ndërveprimin proaktiv ndërmjet dy institucioneve për të shkëmbyer informacion sistematik apo dinamik mbi veprimtarinë respektive institucionale, përfshi këtu edhe shkëmbimin e bazës së të dhënave të operatorëve ekonomik, ku përfshihen të dhënat për NUIS, të cilët regjistrojnë domain.al ose nëndomain.al; të cilët kryejnë veprimtari tregtare online, etj.

Brenda muajit mars 2026

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi me Postën Shqiptare, me qëllim formalizimin e një protokollit të rregullt të shkëmbimit të informacionit, për dërgesat postare që lidhen me tregtinë online, si për importet ashtu edhe për shit-bletjet brenda vendit.

Brenda muajit mars 2026

6. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE

Në vijim të Projekt raportit të dërguar, nga ana e subjekteve të audituara janë paraqitur observacione lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.

Nëpërmjet shkresës nr.4145/2 datë 25.07.2025 protokolluar në KLSH me nr. 767/29 prot., datë 28.07.2025, Ministria e Financave i është drejtuar AKEP me synim realizimin e rekomandimeve nr. 2.1 dhe 2.2.

Nëpërmjet shkresës nr.4145/3 datë 25.07.2025 protokolluar në KLSH me nr. 767/30 prot., datë 29.07.2025, Ministria e Financave i është drejtuar MEKI me synim realizimin e rekomandimeve nr. 1.1, 2.1 dhe 2.2.

Nëpërmjet shkresës nr.4145/4 datë 07.08.2025 protokolluar në KLSH me nr. 767/31 prot., datë 08.08.2025, Ministria e Financave i është drejtuar INSTAT me synim realizimin e rekomandimit nr. 8.1. INSTAT me shkresën nr. 1439/1 prot., datë 18.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.767/34 prot., datë 19.08.2025 në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Financave nuk konfirmon ndryshimin në nomenklaturën NACE.

MEKI me shkresën nr. 10032/1 prot., datë 11.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.767/33 prot., datë 12.08.2025, informon KLSH lidhur me kërkesën e Ministrisë së Financave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në projekt raportin e auditimit nr. 1.1, 2.1 dhe 2.2.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se pavarësisht iniciativës së Ministrisë së Financave për bashkëpunim me institucionet e tjera, informacioni i dërguar në KLSH nga korrespondenca e mësipërme nuk sjell ndryshime në statusin e rekomandimeve të lënë në projekt raportin e auditimit.

Në lidhje me informacionin e dërguar nga MEKI në KLSH sqarojmë:

Rekomandimi 1.1 lidhet me hartimin e një strategjie të dedikuar për tregtinë online. Ndërkohë MEKI i referohet në argumentimin e kësaj pike Urdhërit nr. 397 datë 10.06.2024 “Për miratimin e strukturës së Planit të Veprimit “Për tregtinë elektronike 2024-2027””.

Rekomandimi 2.1 lidhet me hartimin e një kuadri ligjor të plotë dhe të harmonizuar me Direktivat e BE-së. MEKI nuk ka sjellë evidencë, fakte, dokumentacion i cili të mund të merret parasysh nga grupi i auditimit.

Rekomandimi 2.2 lidhet me ndërgjegjësimin dhe informimin e konsumatorëve për të drejtat dhe mënyrën e aksesit, mekanizmat e dëmshpërblimit. Argumentimi i paraqitur nga MEKI nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rekomandimin e mësipërm dhe ka evidencë të cilat mund të merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

Për sa më lart pretendimet e paraqitura nuk merren konsideratë nga grupi i auditimit.

Nëpërmjet shkresës: “Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit “Blerjet Online në Shqipëri, taksat dhe shërbimi ndaj qytetarit”, nr. 2009/1 datë 07.08.2025, protokolluar në KLSH me nr. 767/32 datë 08.08.2025, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka paraqitur observacione si më poshtë vijon:

1. Në faqen 20 të projekt raportit, paragrafi i parafundit shprehet se:

“Në pjesën e taksimit fiskal transaksionet online rregullohen sipas dispozitave të përgjithshme ligjore. Megjithatë paraqitet nevojë për unifikim të veprimtarisë dhe kontributit në rregullimin e formalizimit të këtij tregu në bashkëpunim dhe me institucionet e tjera monitoruese e mbikëqyrëse si AKEP, ISHMT, etj.”

Koment: Sikurse jemi shprehur edhe më parë, AKEP, është organ i pavarur i cili mbikëqyr kuadrin rregullator, të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, ligji për shërbimin postar, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. AKEP e zhvillon veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim kryesor:

- a) promovimin e zhvillimit të tregut të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, bazuar në shtrirjen dhe përdorimin e rrjeteve të shpejtësisë shumë të lartë, konkurrencën e qëndrueshme, ndërveprueshmërinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike, aksesueshmërinë e tyre, sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, si dhe përfitimet e përdoruesit fundor;*
- b) sigurimin e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun në Republikën e Shqipërisë, me cilësi dhe çmime të përballueshme, me mundësi zgjedhjeje për përdoruesit në konkurrencë efektive dhe që janë të afta të plotësojnë nevojat e përdoruesve fundorë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, duke përcaktuar të drejtat e*

nevojshme të përdoruesve fundorë në rastet kur tregu nuk përmbush në mënyrë të kënaqshme kërkesat e aksesimit të shërbimeve në mënyrë të barabartë me të tjerët .

Mbajtur parasysh përcaktimet ligjore të sipërpërmendura, AKEP, në cilësinë e rregullatorit, ka tagër në pjesën e rregullimit të tregut dhe monitorimit të konkurrencës së lirë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve për përdoruesit fundor, pra të qytetarëve. Si pasojë, AKEP, nuk ka në objekt të veprimtarisë së tij, pjesën e taksimit fiskal për transaksionet online. AKEP është tërësisht i angazhuar në pjesën e rregullimit dhe formalizimit të tregut nëpërmjet lëshimit të autorizimeve, brenda kuadrit të vet ligjor dhe pa ndërhyrë në kompetencat ligjore të institucioneve të tjera ligjzbatuese.

AKEP, megjithatë shprehet i gatshëm të bashkëpunojë dhe shkëmbejë informacione e të dhëna me institucionet e tjera që përmenden në këtë Projekt-Raport, me qëllim dhënien e kontributit të tij dhe brenda kompetencave të tij ligjore.

2. *Në faqen 21 të Projekt-Raportit, paragrafi i dytë shprehet se:*

“AKEP mbështetet në bazën ligjore në fuqi, ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", (ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012, nr. 107/2018, datë 20.12.2018; nr. 92/2019, datë 18.12.2019), (i përditësuar), ligji nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë" dhe akte të tjera rregullatore.

Qëllimi i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2018 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka qenë në fuqi është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike, të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike si dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në vështrimin e nevojës ligjore për mbulimin e aktivitetit të AKEP, konstatohet se për blerjet online ky institucion ka një funksion të rëndësishëm për monitorimin e regjistrimit të domaineve të individëve apo subjekteve tregtarë të cilët përdorin platforma të ndryshme digjitale dhe elektronike, por legjislacioni ekzistues i kufizon disa veprime në këtë fushë dhe veçanërisht në bashkëpunimin që duhet të ketë ky institucion me institucionet e tjera monitoruese e mbikëqyrëse të tregut online.

Pengesë për këtë është dhe iniciativa e përmirësimit apo plotësimit ligjor, pasi AKEP i përcjell propozimet nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), pra ka dhe pengesa institucionale nga propozimi deri në dërgimin në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë të një amendamenti ligjor e nënligjor.”

Koment: Sjellim në vëmendje se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, prej datës 20 dhjetor 2024, është shfuqizuar ligji i mëparshëm, nr. 9918/2008. Edhe në kuptim të ligjit 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, komunikimet elektronike janë “shërbimet e internetit, telefonisë celulare, telefonisë fikse, transmetim të dhënash, etj., të përcaktuara qartë edhe në rregulloren e AKEP nr. 47/2017, “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”. Të dy këto aktet ligjore nuk përfshijnë në fushën e tyre të zbatimit, tregtinë elektronike.

Bazuar në kompetencat e tij ligjore, AKEP administron domain TLD.al, nëndomainet e tij, por nuk ka kompetencë lidhur me përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Pra, AKEP, nuk mund të identifikojë në asnjë rast se cilat përmbajtje të faqeve web janë bizneseve të tregtisë online.

Faqet e internetit nuk ndërtohen vetëm me domaine me “.al”, por me çfarëdo domaini tjetër si “.com”, “.biz”, “.bet”, etj., domaine të cilat nuk administrohen nga AKEP dhe për të cilat AKEP-i nuk ka informacion për poseduesit e tyre. Në fakt, këta domaine janë të klasifikuara si domaine të përgjithshme gTLD nga Organizata Ndërkombëtare për adresimet dhe

numeracionet në Internet (ICANN) dhe regjistrohen nga Regjistrues nga mbarë bota, të autorizuar nga ICANN.

Sikurse jemi shprehur edhe në komunikimet e mëparshme, AKEP mund të bashkëpunojë me institucionet kompetente ligjzbatuese duke përgatitur një listë të domaineve “.al”, të regjistruara nga subjekte me NIPT, duke ruajtur njëkohësisht të dhënat personale të poseduesve të këtyre domaineve

Sugjerim: Për këtë çështje dhe brenda kompetencave të tij ligjore, AKEP, do të bashkëpunojë me institucione të tjera të angazhuara në fushën e tregtisë elektronike dhe blerjeve online.

3. Në faqen 21 të Projekt-Raportit, paragrafi i fundit shprehet se:

“Vitet e fundit, shërbimi postar është zhvilluar shumë në drejtim të blerjeve online, (e-commerce) duke sjellë paralelisht ulje të shërbimeve standarde të postës, siç janë dërgesat e letrave, telegrameve etj., e duke bërë që si tregtarët dhe blerësit, ashtu edhe ofruesit e shërbimeve postare të përshtaten me modele të reja të biznesit dhe të lindi nevoja për një qasje të re rregullatore. Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, i cili ushtron efektet e tij prej 10 vitesh dhe evidenton nevojën për ndryshime lidhur me mënyrën e funksionimit të hallkave të e-commerce, e në këtë kuadër, nevojë për rishikim paraqet edhe kuadri rregullator, kjo edhe në zbatim të rekomandimeve të Grupit të Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Postare.....”. Duke qenë se vitet e fundit ka një rritje të blerjeve online, nga faqet zyrtare ËEB, apo dhe nga faqet reklamuese në rrjetet sociale të tregtarëve të ndryshëm, dhe ngërçet apo vakumet e ligjeve aktuale, është evidentuar fenomeni që punonjësit përgjegjës për dorëzimin e objekteve postare të funksionojnë jo vetëm si korrierë, por edhe si agjentë monetarë...Ky është një tregues i qartë i vakumit rregullator që kërkon ndërhyrje për të garantuar sigurinë ligjore dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Koment: Rekomandimet e ERGP dhe Raporti i Komisionit Evropian për Direktivat e Shërbimit Postar të referuar në këtë pjesë të raportit, janë diskutime në nivel komunitar (Komisioni Evropian dhe ERGP) për përmirësime të mundshme të kuadrit aktual rregullator të shërbimit postar (Direktivat e BE-së), ndërsa vendet e BE-së, përfshirë dhe Shqipërinë, zbatojnë Direktivat e Shërbimit Postar që janë aktualisht në fuqi dhe që janë transpozuar në legjislacionet përkatëse kombëtare të vendeve të BE-së, aktualisht ligji nr. 46/2015 në fuqi, në Shqipëri. Me miratimin e direktivave të reja të BE-së, të shërbimit postar edhe në Shqipëri do të ndërmerren proceset përkatëse për transpozimin e tyre, përfshirë përmirësimet në përcaktimet ligjore për shërbimin postar që lidhen me e-commerce, apo të mënyrës së funksionimit të të gjitha hallkave të e-commerce që lidhen me shërbimin postar.

Bëjmë me dije se tregtia elektronike (e-commerce) pjesë e të cilës janë dhe blerjet online si një nga format e saj, rregullohet nga ligji nr. 10128, datë 11.05.2009, “Për tregtinë elektronike”, i ndryshuar, i cili përcakton rregulla lidhur me veprimet tregtare në rrugë elektronike. Institucioni kompetent në fushën e tregtisë, përfshirë dhe rregullimin e blerjeve online, është Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI). Lidhur me ofruesit e shërbimit postar të autorizuar nga AKEP, bazuar në ligjin nr 46/2015, të sipërcituar si dhe aktet rregullatore të dala në zbatim të tij, rregullojnë qartë kushtet për ofrimin e shërbimit postar në Republikën e Shqipërisë.

4. Në faqen 22, të Projekt Raportit, paragrafi i mesit, shprehet se:

“AKEP duhet të fokusohet në garantimin e cilësisë së shërbimeve elektronike dhe në zbatimin e detyrimeve ligjore që lidhen me regjistrimin apo përditësimin e të dhënave në platformat dixhitale dhe marrjen e domaine-ve. Kjo qasje do të mundësojë një konkurrencë të ndershme, mbrojtje më të fortë të përdoruesve online dhe krijimin e një gjurme të plotë auditimi për transparencë dhe kontroll”.

Koment: Bazuar në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores nr. 38, datë 19.11.2015, “Për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, AKEP, regjistron ofruesit e shërbimeve postare, të cilët mund të ofrojnë shërbimet postare vetëm pas regjistrimit në AKEP. Rregullorja nr. 38, përcakton se: ofruesit e shërbimeve postare duhet të plotësojnë standardet dhe cilësinë e shërbimit, rregullat për postimin nga përdoruesi të objekteve postare dhe shpërndarjen e tyre nga ofruesit e shërbimeve postare. Standardet e cilësisë së shërbimeve postare, përcaktohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve. Këto standarde janë në funksion të mënyrës së ofrimit të shërbimit postar, kohës së shpërndarjes, etiketimeve të dërgesave postare, regjistrimeve të tyre, kujdesit në transport për mos dëmtime, etj., por nuk kanë të bëjnë me verifikimin e përmbajtjes apo përbërjes së dërgesave postare.

Gjithashtu, ashtu sikurse jemi shprehur edhe më parë, por edhe gjatë takimeve me grupin e punës së KLSH-së, subjektet me NIPT që regjistrojnë domaine me “.al”, nuk kanë detyrim të shënojnë në formularin e regjistrimit të domainit, objektin e veprimtarisë tregtare të tyre, sepse së pari aktivitetet e tyre tregtare subjektet i deklarojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe së dyti, AKEP, nuk ka burime të mjaftueshme teknike në sistemin e administrimit të domainit “.al”, që të mund të përballojë futjen dhe trajtimin e një informacioni voluminoz nga sistemi teknik. Qëllimi i disponimit të të dhënave të poseduesit të një domaini me “.al” është identifikimi i tij me anën e disa të dhënave, si emri i subjektit, NIPT për faturimet, adresa postare për dërgim fature, dhe kontaktet për komunikim si telefon dhe e-mail.

Në vijim të sa me sipër, AKEP, mund të japë kontribut vetëm brenda kompetencave ligjore të tij.

5. Lidhur me rekomandimin nr. 2.1 sipas të cilit:

“Ministria e Financave, AKEP, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë... të marrin masat për hartimin e një kuadri ligjor të plotë dhe të harmonizuar me direktiva të BE-së, duke përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve dhe tregtarëve në tregtinë elektronike, duke synuar krijimin e një platforme digjitale për Zgjidhjen Alternative dhe Online të Mosmarrëveshjeve (ZAM/ZOM), që mundëson procedura transparente dhe të shpejta për konsumatorët...”

Koment: MEKI ka hartuar projektligjin “Për mbrojtjen e konsumatorit” aktualisht në konsultim publik dhe AKEP është në bashkëpunim të vazhdueshëm me strukturën e MEKI/KMK, për të dhënë mbështetjen dhe propozimet përkatëse. Në informacionin e relatuar nga kjo ministri mbi projektligjin, është realizuar përditësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor shqiptar me standardet më të fundit të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, duke cituar edhe direktivat përkatëse të transpozuar plotësisht.

Gjithashtu, AKEP duke qenë në kuadër të nxjerrjes së akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” që së fundmi ka hyrë në fuqi, është duke hartuar rregulloret e reja, të cilat do të prekin edhe fushën e konsumatorit. Në këtë proces do të mbahen në konsideratë edhe dispozitat që “Ligji për mbrojtjen e konsumatorit” do të parashikojë sa i përket mbrojtjes së konsumatorit: të drejtave dhe detyrimeve / informacioni parakontraktor / kriteret për tregtinë online / kontratat në distancë / përcaktimeve të reja sa i përket produkteve digjitale / parashikimeve për procedurat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve si fushën e komunikimeve elektronike ashtu edhe postare etj. Më konkretisht në draft LMK neni 174/a, parashikon aksesin në një strukturë ZAM dhe ndaj procedurave ZAM e cila siguron krijimin dhe përditësimin e një faqeje interneti, që u ofron lehtësisht palëve informacionin e nevojshëm për procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dhe që i mundëson konsumatorit të dorëzojë një ankesë dhe dokumentet e kërkuara online.

Duke qenë të dyja strukturat në hartimin e drafteve të reja ligjore e nënligjore do të vijojë bashkëpunimi për marrjen e dhënien e mendimeve në këtë proces, duke marrë në konsideratë

direktivat e BE-së në këtë fushë. AKEP do të japë mbështetjen/ekspertizën e nevojshme për çdo kërkesë që mund të vijë nga MEKI, lidhur me krijimin e një platforme online të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

6. Në faqen 23 dhe 24 të Projekt-Raportit, gjetje nr. 4 nga auditimi, konkluzion 4, dhe rekomandim 4.1, shprehet se:

“Ligji nr.46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”paraqet mangësi në lidhje me tregtinë elektronike dhe përafrimin e plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ligji.....nuk adreson në mënyrë të detajuar sfidat e logjistikës dhe shpërndarjes që lidhen me tregtinë elektronike. Po ashtu, mungon një mekanizëm i qartë për transparencën e tarifave për dërgesat e tregtisë elektronike, duke krijuar një pasiguri për bizneset dhe konsumatorët. Edhe pse ligji nr. 46/2015, është pjesërisht i përafëruar me Direktivën 97/67/KE të Parlamentit Evropian, ai nuk përfshin të gjithë elementet e nevojshme për modernizimin e shërbimeve postare në funksion të tregtisë online siç janë standardet e sigurisë dhe mbrojtja e konsumatorit në dërgesat ndërkombëtare”.

Konkluzion 4: “Shërbimi postar ka një rol kyç në mbështetjen e tregtisë online, duke mundësuar qarkullimin e mallrave brenda dhe jashtë vendit, Dinamika e rritjes së këtij tregu, ka krijuar nevojën për përshtatje të kuadrit ligjor rregullator, veçanërisht në harmonizimin me standardet e BE-së. Prandaj, përditësimi i kuadrit ligjor “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, është thelbësor për rritjen e efikasitetit të tregtisë elektronike dhe përputhjen me standardet evropiane.

Rekomandim 4.1: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrin masa për rishikimin e kuadrit ligjor rregullator në fushën e shërbimit postar, ku të përfshihen parashikimet mbi përcaktimin e standardeve për cilësinë e shërbimeve elektronike, përmirësimin e mekanizmave të regjistrimit dhe rifreskimit të licencave për platformat dixhitale, mbrojtjen e konsumatorit, dhe mbështetjen për inovacionin në sektorin postar, ...”.

Koment: AKEP është autoriteti rregullator kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në sa më sipër, nga inspektimet e kryera në terren, si dhe nga monitorimi në distancë i subjekteve ofrues të shërbimeve postare, është evidentuar ndër të tjera edhe nevoja për rishikimin e kuadrit ligjor që mbulon shërbimet postare. Në lidhje me këtë, MIE, si organ kompetent përgjegjës për fushën e shërbimeve postare, përmes shkresës nr. 9922 prot., datë 19.12.2024, ka përcjellë pranë AKEP, draftin e parë të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”. Aktualisht, AKEP, ka përcjellë sugjerimet dhe komentet referuar këtij drafti. Theksojmë sërish se ndërhyrjet në ligjin nr. 46/2015, kanë të bëjnë vetëm me shërbimet postare dhe jo me të gjithë tregun online.

Sic është shpjeguar më lart, rekomandimet e ERGP dhe raporti i Komisionit Evropian për Direktivat e Shërbimit Postar të referuar në këtë pjesë të raportit, janë diskutime në nivel komunitar (Komisioni Evropian dhe ERGP) për përmirësime të mundshme të kuadrit aktual rregullator të shërbimit postar (Direktivat e BE-së), ndërsa të gjitha vendet e BE-së, përfshirë dhe Shqipërinë, zbatojnë Direktivat e Shërbimit Postar që janë aktualisht në fuqi dhe që janë transpozuar në legjislacionet përkatës kombëtare të vendeve të BE-së (ligji nr. 46/2015 në Shqipëri). Me miratimin nga BE-ja të direktivave të reja të shërbimit postar edhe në Shqipëri, do të ndërmerren proceset përkatëse për transpozimin e tyre, përfshirë përmirësimet në përcaktimet ligjore për shërbimin postar që lidhen me e-commerce, apo të mënyrës së funksionimit të të gjitha hallkave të e-commerce që lidhen me shërbimin postar.

Si përfundim, vlen të përmendim edhe njëherë se, në tërësi, përmirësimi i legjislacionit për tregtinë online dhe shërbimet postare janë procese të ndara.

7. Në faqen 32 të Projekt-Raportit, paragrafi i parafundit, shprehet se:
“...AKEP, nuk kryen identifikimin dhe as bllokimin e faqeve. Identifikimi i tyre kryhet nga institucione ligjzbatuese që e kanë një kompetencë të tillë ligjore, ... Referuar gurmës e, të nenit 15, të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, çdo operator/sipërmarrës që ofron shërbime/rrjete të komunikimeve elektronike.....duhet të respektojë kufizimet e transmetimeve me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme. AKEP, përcjell tek sipërmarrësit ...kërkesat e autoriteteve për mbyllje domenesh, faqesh interneti, linke specifike, të konstatuara në shkelje ligjore nga këto institucione...”.

Koment: Sjellim në vëmendje se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, prej datës 20 dhjetor 2024, është shfuqizuar ligji i mëparshëm, nr. 9918/2008.

Referuar shkronjës “ç”, të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe shkronjës “e”, pika 1, të nenit 9, si dhe pikës 9 të Aneksit E, të rregullores së AKEP nr. 47 datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, çdo operator/sipërmarrës që ofron shërbime/rrjete të komunikimeve elektronike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm, duhet të respektojë kufizimet e transmetimeve të përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, nga organet kompetente të parashikuara në legjislacionin respektiv. Bazuar në aktet e mësipërme, “AKEP, me disponimin e kërkesës së organit kompetent të fushës për kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, i drejtohet sipërmarrësit, subjektit që ofron rrjetin dhe/ose shërbimet e komunikimit elektronik publik, për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit të kësaj përmbajtje. Me marrjen e kërkesës nga AKEP për kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, sipërmarrësi është i detyruar të veprojë menjëherë për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit”. Nga sa më sipër, pas kërkesës së organeve kompetente ligjzbatuese, AKEP, u kërkon ISP-ve mbylljen e aksesit të faqeve internetit/url/domain, që transmetojnë përmbajtje të paligjshme

Gjithashtu, pika 2, germa dh, e nenit 12, të ligjit nr. 54/2024, përcakton se AKEP, administron domain-in TLD.al, nëndomainet e tij, si dhe përcakton me rregullore të posaçme rregulla të hollësishme për metodologjinë, pagesat, procedurën dhe mënyrën e menaxhimit të këtij shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare. Në zbatim të këtij neni, dhe rregullores nr. 2 datë 21.02.2008, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën .al dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, të ndryshuar, AKEP mban një regjistër për “domain-namet” e regjistruara dhe entitetet regjistruese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Në zbatim të këtij ligji dhe rregullores nr. 2/2008, AKEP, kryen bllokimin e një domaini .al të regjistruar.

8. Në faqen 24 të Projekt raportit, rekomandimi 2.2, në faqen 34 të Projekt-Raportit, gjetje nr. 9 nga auditimi dhe në faqen 36, rekomandim 9.1, shprehet se:

“Ministria e Financave, AKEP, në bashkëpunim me KMK, MEKI të marrin masa për ndërgjegjësimin dhe informimin e konsumatorëve për të drejtat dhe mënyrat e aksesit në mekanizmat e dëmshtëpërblimit, përmes fushatave publike dhe nismave edukative

“Institucionet objekt auditimi nuk kanë parashikuar fushata sensibilizuese lidhur me tregtinë online, në kushtet kur ky treg paraqitet me rritje të vazhdueshme”.

“Në këtë kuadër rekomandohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të marrin masa për senzibilizimin për tregtinë online me qëllim për të bërë sa më transparente dhe të kuptueshme mënyrën e funksionimit të kësaj veprimtarie si dhe të drejtat dhe detyrimet e subjekteve tregtare që operojnë në këtë fushë”.

Koment: AKEP, mbështetur në parashikimet e ligjit organik nuk ka kompetencë ligjore për blerjet online/tregtinë elektronike, megjithatë shprehet i gatshëm të bashkëpunojë dhe shkëmbejë informacione e të dhëna me institucionet e tjera që përmenden në këtë Projekt-Raport, me qëllim dhënien e kontributit të tij dhe brenda kompetencave të tij ligjore për formalizimin e tregut të blerjeve online.

Informojmë se në vijim të rekomandimit tuaj, Ministria e Financave me shkresën nr. 4145/2 prot., datë 25.07.2025, ka kërkuar qëndrimin e AKEP mbi këtë rekomandim, dhe aktualisht AKEP është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të mëtejshëm të saj.

9. Në faqen 37 të Projekt-Raportit, paragrafi i parafundit, shprehet se:

“AKEP, luan një rol kyç në identifikimin e faqeve dhe platformave që ofrojnë shërbime tregtare online. Një bashkëpunim i mundshëm me DPT dhe ISHMT, do të mundësonte ndërtimin e një baze të dhënash të përbashkët për të gjurmuar aktivitetet tregtare për të parandaluar evazionin fiskal”

Koment: Sikurse kemi theksuar dhe më sipër, bazuar në kompetencat e tij ligjore, AKEP administron domain TLD.al, nëndomainet e tij, por nuk ka kompetencë lidhur me përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Pra, AKEP, nuk mund të identifikojë në asnjë rast se cilat përmbajtje të faqeve ëeb janë bizneseve të tregtisë online.

Faqet e internetit nuk ndërtohen vetëm me domaine me “.al”, por me çfarëdo domaini tjetër si “.com”, “.biz”, “.bet”, etj., domaine të cilat nuk administrohen nga AKEP dhe për të cilat AKEP-i nuk ka informacion për poseduesit e tyre. Në fakt, këta domaine janë të klasifikuar si domaine të përgjithshme gTLD nga Organizata Ndërkombëtare për adresimet dhe numeracionet në Internet (ICANN) dhe regjistrohen nga Regjistrues nga mbarë bota, të autorizuar nga ICANN.

Sikurse jemi shprehur edhe në komunikimet e mëparshme, AKEP mund të bashkëpunojë me institucionet kompetente ligjzbatuese duke përgatitur një listë të domaineve “.al”, të regjistruara nga subjekte me NIPT, duke ruajtur njëkohësisht të dhënat personale të poseduesve të këtyre domaineve

Për këtë çështje dhe brenda kompetencave të tij ligjore, AKEP, do të bashkëpunojë me institucione të tjera të angazhuara në fushën e tregtisë elektronike dhe blerjeve online.

10. Në faqen 39 dhe 40 të Projekt-Raportit, gjetje nr.13 nga auditimi dhe rekomandim 13.1, shprehet se:

“Marrëveshja e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me qëllim vendosjen e një niveli të ri ndërveprimi institucional për të shkëmbyer informacion dhe të dhëna sistematike mbi veprimtarinë respektive, për forcimin e luftës kundër informalitetit të subjekteve që kryejnë veprimtari në fushën e tregtisë online nuk ka gjetur zbatim për periudhën objekt auditimi... “.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të marrin masa të zbatojnë marrëveshjen e bashkëpunimit..... ti kërkojë AKEP marrjen e të dhënave dhe informacioneve në lidhje me përdoruesit e ndërfaqeve elektronike të regjistruara në domain.al., të cilët kryejnë veprimtari në fushën e tregtisë elektronike”.

Koment: AKEP, shpreh angazhimin e plotë për rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në shkëmbimin e informacionit që administron brenda fushës së tij të kompetencave.

11. Në faqen 39 dhe 40 të Projekt-Raportit, gjetje nr. 14 nga auditimi dhe rekomandim 14.1, shprehen se:

“Nga auditimi i marrëveshjes së bashkëpunimit”, midis Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, e lidhur në periudhën 16.01.2019 - 15.01.2022, me qëllim shkëmbimin sistematik, të informacionit mbi veprimtarinë institucionale, përfshirë edhe fushën e tregtisë elektronike, nuk është shfrytëzuar nga asnjëra nga palët gjatë afatit të saj ...nuk është lidhur ndonjë marrëveshje tjetër bashkëpunimi për shkëmbim periodik të informacionit në fushën e tregtisë elektronike”

“Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, marrin masa për të lidhur një marrëveshje ndërmjet tyre me qëllim ndërveprimin proaktiv ndërmjet dy institucioneve për të shkëmbyer informacion sistematik, përfshi këtu edhe shkëmbimin e bazës së të dhënave të operatorëve ekonomik, ku përfshihen të dhënat NUIS, të cilët regjistrojnë domain.al., të cilët kryejnë veprimtari në fushën e tregtisë elektronike”.

Koment: Për sa më sipër, AKEP, shpreh angazhimin e plotë për rritjen e bashkëpunimit me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në shkëmbimin e informacionit që administron brenda fushës së tij të kompetencave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa në lart sqarojmë se, pothuajse në të gjithat pikat e mësipërme AKEP ka shprehur gatishmërinë në përmbushjen e zbatimit të rekomandimeve në bashkëpunim me subjektet e tjera, siç edhe është trajtuar në gjetjet dhe rekomandimet nga grupi i auditimit.

Sa i takon komentit për hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, prej datës 20 dhjetor 2024 dhe shfuqizimit të Ligjit të mëparshëm, nr. 9918/2008, sqarojmë se auditimi përfshin periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2020-31.12.2024, gjatë së cilës Ligji nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ka qenë në fuqi. Gjithashtu vlen të theksojmë se ndryshimet e ligjit për komunikimet elektronike, nuk sjellin ndryshim në qasjen e grupit të auditimit lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e lëna.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT